



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raport i “Albanian University”
Maj 2017**

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

- | | |
|-----------------------------|----------|
| 1. Dr. Heather Barrett-Mold | Kryetare |
| 2. Profesor Sherif Bundo | Anëtar |
| 3. Profesor Ed Esche | Anëtar |
| 4. Dr. David Taylor | Anëtar |

Datë:18-19 maj 2017

Përmbajtja

Përmbajtja.....	3
Rreth këtij vlerësimi.....	1
Konteksti i këtij vlerësimi	2
Raport i përmbledhur	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	5
Raporti i detajuar.....	7
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	7
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	11
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	17
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	21
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	25
Lista e dokumenteve	29

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle institucionet e arsimit të lartë (IAL-të) përmbushin Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve nga Mbretëria e Bashkuar, të caktuar nga QAA-ja dhe të ekspertëve shqiptarë, të caktuar nga APAAL-i. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'iu ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesit që ofruar e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxënësve të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

“Albanian University” është një institucion privat i arsimit të lartë, i licencuar në prill të vitit 2004 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, me vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Studentët e tij të parë u regjistruan në vitin akademik 2004-2005, me kursin e parë të studimeve në degën e stomatologjisë. Universiteti krenohet me ndërthurjen e mësimdhënies me kërkimin. Në të njëjtin vit ai organizoi edhe Konferencën e tij të parë për Stomatologjinë. Në vitin akademik 2005-2006, universiteti i pajisi studentët me diploma universitare në degët: Farmaci, Arkitekturë, Shkenca Juridike dhe Shkenca Politike. Universiteti i promovoi këto programe studimi dhe në vitin akademik 2006-2007 arriti shifrën prej kishte 2,000 studentë të regjistruar.

Universiteti nxit përfshirjen e akademikëve, studentëve dhe palëve të interesit në diskutime dhe çështje publike, nëpërmjet forumeve, workshop-eve, seminareve, konferencave dhe debateve. Në prill të vitit 2007, krahas shtëpisë botuese “UFO Press”, universiteti e zgjeroi hapësirën e tij publike, nëpërmjet televizionit “UFO Education” (tashmë “UTV News”), i cili u ideua, për të qenë një televizion edukativ. Gjithashtu, universiteti ofroi programe të reja të studimeve në ciklin e dytë dhe të tretë, duke mbështetur specializimin e mëtejshëm të studentëve të tij, lidhjet më të ngushta me nevojat e tregut të punës dhe bashkëpunime më të gjera, nëpërmjet mësimdhënies së ofruar nga pedagogë të huaj. Gjatë vitit akademik 2012-2013, universiteti e zhvilloi më tej dhe i ofroi një gamë të gjerë programesh të ciklit të dytë, Master Profesional në degën e Infermierisë dhe Psikologjisë, si dhe krijimin e programeve të ciklit të tretë për Doktoratura në fushën e Shkencave Juridike, Ekonomisë, Psikologjisë, Shkencave Politike, Farmacisë dhe Arkitekturës. Tashmë universiteti po i jep përparësi konsolidimit të cilësisë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Raport i përmbledhur

“Albanian University” është institucion privat i arsimit të lartë, i licencuar në prill të vitit 2004 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, me vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. “Albanian University” është ndër universitetet e para private të themeluara në Republikën e Shqipërisë që ushtron veprimtarinë e tij prej më shumë se 10 vite, dhe që aktualisht është i ndarë në tre fakultete: Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Universiteti ndodhet në Tiranë dhe ka gjashtë godina, ndërsa një godinë tjetër planifikohet të përfundojë në shtator të vitit 2017. Ndër to përfshihet edhe Klinika Universitare, që është pjesë e rëndësishme e programit të studimit në zbatim të kurrikulës së Departamentit të Stomatologjisë. Pranë Klinikës ndodhet “Day Hospital” (Spitali Ditor), që ka salla kirurgjie dhe shtrim 24-orësh spitalor. Universiteti ofron 48 programe studimi në të tre ciklet e studimeve në të gjitha fakultetet e tij, si dhe përdor Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Ai ofron 16 programe studimi të ciklit të parë të studimeve, 24 programe të ciklit të dytë dhe 8 programe të ciklit të tretë. Gjatë kryerjes së vizitës së vlerësimit, “Albanian University” kishte 6,964 studentë të regjistruar në të gjitha programet e tij.

Një grup nga universiteti, që përfshinte edhe një përfaqësues të studentëve, përpiloi raportin e vetëvlerësimit (RVV). Projektraportet iu shpërndanë një audience të gjerë brenda institucionit përpara përfundimit dhe miratimit të versionit përfundimtar nga Rektori. RVV-ja është gjithëpërfshirëse dhe informuese, megjithëse do të ishte e dobishme nëse shkalla e vlerësimit do të ishte më e lartë.

Vizita u krye gjatë dy ditëve, në datat 18 dhe 19 maj 2017. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga tre ekspertë të arsimit të lartë me përvojë, nga Mbretëria e Bashkuar, dhe një anëtar me përvojë në arsimin e lartë nga personeli i institucioneve shqiptare. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mbështetej nga Menaxheri i Vlerësimit dhe një person i caktuar për mbajtjen e shënime, nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri (APAAL). Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion raporti i vetëvlerësimit dhe dosja me dokumentet mbështetëse, tetë javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, të plotësuara më pas nga dokumentet e kërkuara shtesë. U morën në konsideratë gjithsej 217 dokumente, të cilat e ndihmuan grupin e vlerësimit të njëjti me strukturën, politikën dhe procedurat e menaxhimit, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore të ndërmarrë nga universiteti. Këto dokumente përfshinin Statutin e universitetit, rregulloret akademike, raportet vjetore, procedurat e pranimit dhe orientimit, listën e marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumeve, shembujt e informacioneve rreth programeve, si dhe evidencat e mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë vizitës së vlerësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me drejtues të nivelit të lartë, studentë, pedagogë, personelin administrativ dhe atë mbështetës, si dhe me partnerë të jashtëm dhe punëdhënës. Diskutimi u mbështet në qartësimin e procedurave, përgjegjësi dhe pikëpamjeve. Në të gjitha mbledhjet u mbajtën shënime. Si pjesë e turit të kampusit kryesor, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën, auditorët, laboratorët, dhe zyrat.

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur. Qeverisja dhe kuadrot rregullatorë të “Albanian University” janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, me misionin dhe objektivat e tij. Universiteti menaxhohet me efikasitet. Organet e brendshme drejtuese përfshijnë: Senatin Akademik, Bordin e Administrimit, Rektoratin, Këshillin e Etikës, Këshillin e Profesorëve, Këshillat e Fakultetit, dhe Këshillat e Departamentit. Lidhjet e forta ndërmjet Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe departamenteve përbëjnë praktikë e mirë. Një tjetër praktikë e mirë është edhe fakti që universiteti kryen kërkime shteruese, për të

përmbushur misionin dhe qëllimin e tij, duke përfshirë studim të detajuar të tregut të punës, i cili përfshin një analizë të vendeve të punësimit të të diplomuarve.

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht. Universiteti e ushtron veprimtarinë e tij në një sërë godinash, që në përgjithësi janë të mirëpajisura dhe kanë teknologji të mirë informacioni. Po ndërtohet edhe një godinë e re që do të vihet në përdorim nga shtatori të vitit 2017. Praktikë e mirë është edhe Klinika e mirëpajisur Universitare për stomatologjinë. Emërimi i stafit bëhet në përputhje me legjislacionin, por është evidentuar largimi në shkallë të gjerë i stafit gjatë tre viteve të mëparshme, gjë që është konsideruar si dobësi dhe universitetit i rekomandohet që të vlerësojë ndikimin e kësaj. Universiteti po krijon një sistem të ri të bazës së të dhënave për teknologjinë e informacionit, dhe është pohuar nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm. Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre caktohet në bazë të programit financiar trevjeçar.

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur. Para hapjes së programeve të reja, universiteti zhvillon studime tregu. Universiteti ka një plan ambicioz për ofrimin e disa prej programeve të tij të studimit në gjuhën italiane, si dhe në gjuhën shqipe. Programi i parë është miratuar së fundmi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Aktualisht, programet në nivel doktorat nuk janë akredituar, por gjatë kryerjes së vizitës ishte në pritje të vendimit. Programet e universitetit promovohen në mënyrë aktive për ata që e kanë braktisur shkollën dhe për të tjerë nëpërmjet faqes së tij të internetit, lajmeve në televizion, rrjeteve sociale dhe takimeve me maturantët nga shkollat e mesme. Shfrytëzimi i mundësive të promovimit në televizion dhe rrjetet sociale është praktikë e mirë.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur pjesërisht. Universiteti ka rregulla dhe procedura të qarta për të siguruar përmbushjen e kërkesave të studentëve në çdo nivel studimi. Ky proces është i rregulluar dhe i dokumentuar. Leksionet alternohen me punën praktikë. Në Fakultetin e Mjekësisë, studentët punojnë drejtpërdrejt me pacientët në klinika ose në struktura të sektorit të shërbimeve. Cilësia e programeve të studimit dhe mësimdhënies vlerësohet vazhdimisht nga departamentet. Është krijuar edhe një Shkollë Doktorature, por programet e saj nuk janë akredituar ende. Mungesa e programit doktorat të akredituar, ku disa studentë po vazhdojnë studimet e tyre, përbën dobësi. Departamentet nuk kanë fokus të qartë dhe gjithëpërfshirës për kërkimin. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si dobësi mungesën e strategjisë. Rekomandohet që universiteti të qartësojë dhe të zbatojë prioritetet e tij.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur. Universiteti i orienton dhe i këshillon si duhet studentët e tij. Studentët i treguan Grupit të Vlerësimit të Jashtëm se çdo pedagog shpjegon të gjitha aspektet e secilit modul në fillim të çdo semestri, dhe se ata janë të kënaqur me baraspeshën ndërmjet teorisë dhe praktikës në programet e tyre. Ka mundësi këshillimi dhe konsultimi për studentët që nga kontakti i tyre i parë me universitetin, në lidhje me informacionin për programet e tyre, deri pas diplomimit të tyre. Kjo përfshin këshillim dhe tutorim akademik, këshillim dhe mentorim metodologjik, si dhe leksione të hapura. Manualët e studentëve janë të përshtatshme dhe përfshijnë të drejtat dhe detyrimet e studentëve, transferimin e studentëve, dhe procedurat disiplinore. Ato nuk përfshijnë mënyrën e vlerësimit ose ankimit. Praktikë e mirë është edhe nxitja dhe kushtimi i vëmendjes zërit të studentëve.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- marrëdhënien e konsoliduar midis Zyrës dhe të paktën një anëtari të stafit akademik me kohë të plotë nga secili departament, i ngarkuar me sigurimin e cilësisë (pika 1.4; **Kapitulli III Standard I.2**)
- analizën që synon të hartëzojë kërkesat e tregut të punës me përgatitjen universitare, e ndihmon shumë universitetin të përmbushë misionin dhe qëllimin e tij (pika 1.9; **Kapitulli III Standardi III.1**).
- ofrimin e 70 hapësirave të cilësisë së mirë për kirurgji me ndenjësë, për përdorim nga studentët në klinikën dentare (pika 2.18; **Kapitulli III Standardi VII.5**).
- përdorimin novator të televizionit dhe medias sociale për reklamimin e programeve dhe ditëve të hapura të universitetit për audiencat e synuara (pika 3.2; **Kapitulli I Standardi I.1**).
- nxitjen dhe vëmendjen e kushtuar ndaj zërit të studentëve, në mënyrë që ata të luajnë një rol efikas në përmirësimin e përvojave të tyre mësimore (pika 5.7; **Kapitulli I Standardi III.7**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- largimin e një numri të madh pedagogësh gjatë tre viteve të mëparshme (pika 2.2; **Kapitulli III Standardi IV.1**).
- mungesën e akreditimit të programit doktoral, ku aktualisht disa studentë vazhdojnë studimet e tyre (pika 4.2; **Kapitulli I Standardi II.2**)
- numrin e pakët të projekteve, ku angazhohet universiteti krahasuar me numrin e stafit akademik dhe studentëve (pika 4.7; **Kapitulli II Standardi I.1; Kapitulli II Standardi I.4; Kapitulli II Standardi I.6**)
- mospasjen nga ana e departamenteve e një përqendrimi të qartë dhe gjithëpërfshirës kundrejt veprimtarisë kërkimore (pika 4.9; **Kapitulli II Standardi I.4**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- vlerësimin nga ana e universitetit të ndikimit të lëvizjes së madhe vjetore të stafit dhe marrjen e masave të përshtatshme (pika 2.2; **Kapitulli III Standardi IV.1**).
- ndjekjen e hapave nga universiteti për gjetjen e një mënyre për kualifikimin e të gjithë studentëve të regjistruar në programin doktoral (pika 4.2; **Kapitulli I Standardi II.2**)
- ndjekjen e një qasjeje strategjike për zhvillimin e kërkimit dhe miratimin e një plan veprimi (pika 4.7; **Kapitulli II Standardi I.1; Kapitulli II Standardi I.4; Kapitulli II Standardi I.6**)
- qartësimin dhe zbatimin nga ana e universitetit të prioriteteve të tij për veprimtarinë kërkimore (pika 4.9; **Kapitulli II Standardi I.4**).
- Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e ndërmarrë si më poshtë:

- prezantimin e softuerit të ri të teknologjisë së informacionit (pika 2.13; **Kapitulli III Standardi VII.1**).

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përmbushur**.
- 2 Standardet për Burimet janë **përmbushur kryesisht**.
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përmbushur**.
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përmbushur pjesërisht**.
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përmbushur**.

Gjykim i përmbledhur

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon Këshillit të Akreditimit se në “Albanian University”, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përmbushur kryesisht**.

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

1.1 Qeverisja dhe kuadrot rregullatorë të “Albanian University” (universiteti) janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, me misionin dhe objektivat e tij. Ai e ushtron veprimtarinë e tij si një institucion privat i arsimit të lartë në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.05. 2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe ndryshimeve të tij, si dhe me nenin 49 të Statutit të brendshëm ligjor dhe nenit 53 të Rregullores së tij.[RVV fq.5; 1.1; 1.2] Me kalimin e viteve, ai ka ndryshuar vazhdimisht Statutin dhe Rregulloren e tij, ku vendimi më i fundit është ai i Rektoratit për ndryshimin e strukturës institucionale të universitetit.[RVV fq.5; 1.3] Në përputhje me ligjin nr. 80/2015, datë 07.09.2015, 'Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë', universiteti po bën sërish ndryshime; ka përfituar miratimin e Statutit të tij të ri prej 88 nenesh nga Senati dhe në vijim të urdhrit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe ka hartuar Rregulloren e tij prej 59 nenesh.[RVV fq.5-6; 1.4; 1.5; 1.6; 1.7] [Kapitulli III Standardi I.1]

1.2 Universiteti administrohet në mënyrë efikase, nëpërmjet një strukture organizimi dhe raportimi të qartë ndërmjet njësive të universitetit që luajnë rol të rëndësishëm në administrimin e tij. Përfaqësimi në shkallë të gjerë në komisione ndihmon në përforsimin e mirëkuptimit të përgjegjësive për mbikëqyrjen e menaxhimit. Organet e brendshme drejtuese janë: Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektorati, Këshilli i Etikës, Këshilli i Profesorëve, Këshillat e Fakultetit, dhe Këshillat e Departamentit.[RVV, fq.6-7; 1.1, nenet 7, 8, 9, 10, 16, 17; 1.8 a, b; 1.9; 1.2 neni 19; B.4; C.10 f; C.27; C.28] Këshilli i Profesorëve organizon dhe drejton studimet doktorale.[1.1 neni 17; M6] Autoritetet drejtuese të universitetit janë Rektori, zëvendës rektorët, Administratori, Sekretari i Përgjithshëm, dekanët e fakulteteve (të emëruar së fundmi, por që do të zgjidhen me hyrjen në fuqi të ligjit të ri) [M4] dhe përgjegjësit e departamenteve.[RVV fq.6-7; 1.1, nenet 7, 11, 12, 13, 14, 25, 27] Pas marrjes së kërkesave dhe informacionit nga të gjitha zyrat dhe departamentet e universitetit, Rektorati përgatit dhe ia dorëzon buxhetin për miratim Senatit Akademik. Më pas, Senati Akademik ia paraqet atë Bordit të Administrimit për miratimin përfundimtar.[RVV fq.6; 1.2 neni 5, fq.6; si dhe nenet 4-10; 1.1 nenet 8, 4.fq, 9, 2.e, 10, 5.b; M1] Ulja e shpenzimeve institucionale dhe shtimi i shpenzimeve për shërbimet e studentëve janë prioritet i buxhetit aktual.[M4] Programet e ciklit të tretë ofrohen në tre fakultete dhe në dhjetë departamentet e tyre.[1.1 neni 22, fq.12-13] [Kapitulli II Standardi I.2; Kapitulli III Standardi II.3]

1.3 Senati dhe Bordi i Administrimit organizojnë mbledhje në mënyrë periodike, ku diskutojnë për çështje me rëndësi për universitetin, duke përfshirë edhe buxhetin, Planin e Zhvillimit dhe Raportin Vjetor. Ata marrin gjithashtu më shumë parasysh çështje vendore, si ndryshimet në kurrikul, oraret e provimeve dhe ankimimet e studentëve.[M11; M12; M13] Vendimet merren sipas hierarkisë, duke kaluar nga Këshillat e Departamenteve në Këshillat e Fakulteteve, dhe më pas në Senatin Akademik.[M3; C.23] Senati Akademik mblidhet tre herë gjatë një tremujori [RVV fq.8; 1.8a, neni 14] sipas një axhende të përcaktuar, që propozohet nga Rektori, si kryetari i Senatit. Rektorati paraqet për diskutim pikat e axhendës, të cilat i dërgohen paraprakisht anëtarëve të Senatit.[RVV fq.7; 1.8a, neni 8] Vendimet e Senatit nënshkruhen nga Rektori dhe bëhen publike brenda tre ditësh nga përmbyllja e mbledhjes.[1.8a, neni 11] Megjithëse universiteti nuk përdor planet e veprimit të mbledhjeve, vendimet për veprimet e marra nga organet kolegjiale mbikëqyren nga kryetarët në fillim të secilës mbledhje. Si rrjedhojë, përgjegjësi i departamentit monitoron vendimet e marra në Këshillin e mëparshëm të Departamentit, ndërsa Dekani monitoron vendimet e marra në Këshillin e mëparshëm të Fakultetit, e kështu me radhë.[M3; M4] Megjithatë, rezultoi se ky proces nuk ndiqej për mbledhjet e Rektoratit.[C.30] Bordi i Administrimit mblidhet në takim me dyer të mbyllura të paktën një herë në muaj, por mund të

organizojë edhe mbledhje të jashtëzakonshme.[RVV fq.8; 1.10 neni 5] Mbledhja thirret nga Administratori, i cili qarkullon axhendën dhe çështjet kryesore që do të diskutohen gjatë saj.[RVV fq.8; 1.10 neni 5, fq.2, neni 8] Megjithëse procesverbalet publikohen, fakti që zhvillohet me dyer të mbyllura dhe që iu përgjigjet pronarëve të universitetit, ngre çështje të transparencës, dhe paraqet rrezikun e keqkuptimit të vendimeve të marra në fshehtësi.[C.26; M15] [Kapitulli III Standardi I.3; Kapitulli III Standardi II.1; Kapitulli III Standardi II.3]

1.4 Ka një sërë mekanizmesh të brendshme që sigurojnë funksionimin me efektshmëri të universitetit brenda kufijve të autonomisë së tij, duke përfshirë: funksionet drejtuese të dy zëvendës rektorëve, [1.2 neni 8, fq.11] Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, dhe Manualin e saj [RVV fq.9; 1.12; 1.11] dhe, në varësi të numrit të pedagogëve të departamentit, një deri në tre anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë që janë përgjegjës për sigurimin e cilësisë në nivel departamenti.[RVV fq.9; 1.13; M11; M12; M13] Anëtari i departamentit që është përgjegjës për sigurimin e cilësisë trajnohet nga Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe krijon lidhjet ndërmjet studentëve, departamentit dhe Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Marrëdhënia e konsoliduar midis Zyrës dhe të paktën një anëtari të stafit akademik me kohë të plotë nga secili departament, i ngarkuar me sigurimin e cilësisë, përbën karakteristikë e praktikës së mirë. Kjo siguron ndjekjen me kujdes të politikës dhe praktikës institucionale për përmbushjen e standardeve në secilin departament.[Kapitulli III, Standardi I.2]

1.5 Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë bashkëpunojnë për zgjerimin e partneriteteve dhe përfitimin e financimeve nga vende të Bashkimit Evropian dhe nga vende të tjera.[RVV fq.9; 1.1 nenet 20, 21, fq.11; 1.15] Deri më sot, ka qenë e suksesshme vetëm një ofertë për financime ndërkombëtare, ajo për projektin Erasmus+, ndërsa disa të tjera janë aktualisht në pritje.[M2] Aktualisht, universiteti ka angazhuar për këtë çështje dy konsulentë ligjorë, njërin për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulës, dhe tjetrin për marrëdhëniet e jashtme.[RVV fq.9; 1.14][Kapitulli III Standardi I.4]

1.6 Zhvillimi strategjik i universitetit mbështetet në një plan strategjik të efektshëm për periudhën 2013-2017.[RVV fq.10; 1.16] Ai u përpilua nga Rektori pas konsultimit të gjerë me strukturat e universitetit.[M2; M4; M12; M13] Ai përfshin misionin të përcaktuar në pesë pika dhe gjashtë objektiva: Organizimi Institucional; Mësimdhënia, Kurrikula dhe Mësimnxënia; Kërkimi Shkencor; Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë; Shërbimet; dhe Marrëdhëniet me Jashtë.[1.16] Në të përfshihen masa afatshkurtra, si rishikimi i secilit program, dhe masa afatgjata, si ndërkombëtarizimi i shërbimit në gjashtë programe të reja, që do të zhvillohen në gjuhën italiane.[M1; M12; M13] Strategjia e re 2017-2022 është aktualisht në proces diskutimi dhe zhvillimi.[RVV fq.10; M12; M13] [Kapitulli III Standardi I.5]

1.7 Raporti vjetor i universitetit diskutohet në rreth të gjerë dhe hartohet në nivele të ndryshme, duke përfshirë departamentet, këshillat e fakultetit, Rektoratit, Senatit Akademik dhe Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, para dorëzimit për verifikim në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe para publikimit të tij në faqen zyrtare të internetit të universitetit.[RVV fq.10; 1.1 neni 8, 4.o, fq.4; 1.2 neni 22, 3, fq.22, neni 19, 1.c, fq.19, neni 13, 4, fq. 15, neni 5, 5, fq.7; 1.18; <http://albanianuniversity.edu.al>; C.18; C.19; C.20; C.21; C.22; C.29; C.30; C.31; M1; M4] Ai përmban të dhëna të dobishme, duke përfshirë burimet e përgjithshme të fakultetit, përqindjet e kalueshmërisë dhe marrëveshjet e bashkëpunimit, [1.17 fq.13, 11; 24-5] por nuk i vlerëson në mënyrë analitike të dhënat që paraqet. Ai përmbledh disa ankime të studentëve pa bërë të ditura rezultatet.[1.17 fq.11] Në të përfshihet edhe një analizë e pikave të forta, pikave të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve (SWOT), por nuk përfshihet as plan veprimi e as synimet specifike, të matshme, të

arritshme, të rëndësishme dhe të përcaktuar me afat (SMART), për t'u përmirësuar.[1.17 fq.26-27] **[Kapitulli III Standardi I.6]**

1.8 Universiteti ka struktura të përshtatshme për përmbushjen e misionit dhe qëllimit të tij. Ai e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e autonomisë institucionale dhe lirisë akademike, të shprehura në Statutin e tij.[RVV fq.11; 1.1 neni 6, fq.3] Ai ofron programe studimi në të tre ciklet: Bachelor, Master dhe programe specializimi të ciklit të tretë dhe doktorat.[RVV, fq.12; 1.1 neni 35, fq.17] Aktualisht, ka studentët të regjistruar në programet e studimeve doktorale.[M6] Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu komunikua se universiteti ishte në pritje të përgjigjes rreth aplikimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për akreditimin e ciklit të tyre të tretë të studimeve.[M4] Pas takimit me Rektoratin, kolegët shqiptarë shpjeguan se kjo jodomosdoshmërisht i rrezikonte studentët, sepse ata mund t'i transferojnë studimet e tyre në një tjetër institucion, për të marrë diplomën e tyre. Në mbledhjen e vlerësimit, përfaqësuesit e APAAL-it shpjeguan gjithashtu se aplikimi i mëparshëm i universitetit për ofrimin e ciklit të tretë të studimeve nuk ishte pranuar (shihni pikën 4.2).[shënime personale nga mbledhja e vlerësimit] Secili departament përbëhet nga të paktën shtatë anëtarë, nga të cilët pothuajse 50% e tyre kanë grada ose tituj akademikë.[RVV fq.12; 1.19] AU ka faqen e saj zyrtare të internetit www.albanianuniversity.edu.al.**[kontrolluar më 29 mars 2017] [Kapitulli III Standardi II.1]**

1.9 Universiteti kryen kërkim shterues për përmbushjen e misionit dhe qëllimit të tij, duke përfshirë një analizë të detajuar të tregut të punës për ofrimin e programeve të tij, siç evidentohet në studimin “Analiza e Tregut të Punës 2015-2016” për Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Raporti ndahet në katër seksione kryesore: “të dhëna kontekstuale për çështjet dhe temat përkatëse të kërkimit; të dhëna për vendet e punësimit të të diplomuarve në tregun e punës; informacion për perceptimet e punëdhënësve lidhur me punësimin e të diplomuarve; dhe rekomandime për hartimin e politikave për përputhshmërinë (e saktë) të aftësive të përvetësuar në universitet me ato që kërkohen në tregun e punës”.**[RVV fq.13; 1.20]** Një analizë e tillë, që synon të hartëzojë kërkesat e tregut të punës me përgatitjen universitare, e ndihmon shumë universitetin të përmbushë misionin dhe qëllimin e tij për ofrimin cilësor të arsimit universitar dhe profesional **[1.1, neni 5]**, dhe përbën një karakteristikë të **praktikës së mirë**. Zyra e Karrierës, Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët mbledh rregullisht të dhëna për përqindjen e punësimit të studentëve sipas fushës së tyre të studimit dhe vitit të diplomimit, **[RVV fq.54; 3.12; M3]**, por paraqitja e të dhënave konsiston në një regjistër numerik të të diplomuarve të punësuar në fushën e tyre të studimit dhe jo një analizë, dhe si rrjedhojë, universiteti nuk mund të monitorojë efikasitetin e masave të ndërmarra për përmirësimin e punësueshmërisë së të diplomuarve të tij.**[Kapitulli III, Standardi III.1]**

1.10 Universiteti ndjek një strategji bashkëpunimi dhe partneriteti në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Universiteti ka zhvilluar një strategji të qartë partneriteti, e cila përmban qëllime thelbësore strategjike dhe përcakton me efikasitet se si mund të arrihen ato në një plan veprimi afatgjatë.**[RVV fq.14; 1.21]** Arritjet e fundit të kësaj strategjie përfshijnë marrëveshje me Universitetin Bujqësor të Kamzës, Universitetin e Sporteve të Tiranës, Kolegjin Polanski në Kwidzin dhe Universitetin e Napolit “Federico II”.**[RVV fq.14; C.2; C.3; C.4]** Universiteti ka nënshkruar 40 marrëveshje me partnerët në rajon dhe bashkëpunon me disa prej tyre gjatë zhvillimit të programeve të reja.**[RVV fq.14; M8]** Disa prej partnerëve vendorë përfshijnë arkitektë, qendra për të moshuarit, shkolla, njësi të bashkisë, prodhues të mineralit të kromit, spitale, shoqëri farmaceutike, shoqëri kontabiliteti dhe një linjë të madhe ndërkombëtare për transportin detar.**[M8]** Agjencia e rekrutimit të infermierëve, PMK Medical Care, bashkëpunon me universitetin dhe 120 studentë kanë nënshkruar marrëveshje me të.**[M8]** Bashkëpunimi i universitetit me institucionet ndërkombëtare përfshin marrëveshje bashkëpunimi me 12 universitete ndërkombëtare, ftesa për lektorët e ftuar dhe pjesëmarrje në programin Erasmus+.**[RVV fq.14-15; 1.23; 1.22; 1.24; Video (që nuk është parë)]** Gjatë

kryerjes së vlerësimit të jashtëm, lista e të gjithë partnerëve të universitetit rendiste 94 marrëveshje rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare. **[C.5] [kapitulli III Standardi III.2]**

1.11 Universiteti bashkëpunon me 46 institucione të jashtme për ofrimin e praktikave profesionale të studentëve, **[RVV fq.15; 1.25]**, por nuk është e qartë nëse të gjitha këto institucione angazhohen rregullisht në mbështetjen e studentëve. Ai ka gjithashtu marrëveshje bashkëpunimi me 65 institucione për mbështetjen e programeve të tij, si me organe qeveritare, ashtu edhe me universitete ndërkombëtare, **[1.26]** por sërish mbetet e paqartë se si shumë prej tyre kontribuojnë në mënyrë aktive për universitetin. **[Kapitulli III Standardi III.3]**

1.12 Universiteti mbështet një pjesë të vogël të mobilitetit ndërkombëtar për stafin akademik dhe studentët. Stafi i tij akademik merr pjesë në konferenca ndërkombëtare, të organizuara kryesisht në Tiranë. **[1.27]** Ai ka nënshkruar marrëveshje që mundësojnë shkëmbime të studentëve dhe stafit akademik, nëpërmjet projektit Erasmus+ dhe ka aplikuar në projekte të tjera, si për shembull me Universitetin e Pisës dhe Universitetin e Padovas. **[RVV fq.15; 1.15]** Universiteti ka paguar tarifën për disa nga studentët për pjesëmarrjen në konferencën e Universitetit të Janinës **[M5]** dhe mbështeti një student në lidhjen e një bashkëpunimi me Universitetin e Vjenës. **[M6] [kapitulli III Standardi III.4]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- marrëdhënien e konsoliduar midis Zyrës dhe të paktën një anëtari të stafit akademik me kohë të plotë nga secili departament, i ngarkuar me sigurimin e cilësisë (pika 1.4; **Kapitulli III Standardi I.2**)
- analizën që synon të hartëzojë kërkesat e tregut të punës me përgatitjen universitare, e ndihmon shumë universitetin të përmbushë misionin dhe qëllimin e tij (pika 1.9; **Kapitulli III Standardi III.1**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha rekomandime.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

2.1 Struktura institucionale e “Albanian University” [2.1] është e publikuar në faqen e internetit. Rekrutimi i stafit për veprimtarinë kërkimore dhe për mësimdhënie, dhe i personelit mbështetës dhe administrativ realizohet në përputhje legjislativ. [1.1, neni 43, fq.21; 2.4 - a, b, c, d, e] Çdo i punësuar ka një kontratë individuale të punës. [1.1, neni 39, pika b, c, fq.20] Universiteti kthen në prioritet rekrutimin e stafit akademik të kualifikuar, që është diplomuar jashtë shtetit, dhe në veçanti, çmon punësimin e stafit akademik nga bashkëpunëtorët e tij të huaj. Kriteret përcaktohen në muajin korrik dhe të në bazë të tyre krijohet një profil rreth nevojave të universitetit për vitin pasardhës, që identifikon gjithashtu nevojat për rekrutimin e stafit. Vendet e punës shpallen në faqen e internetit dhe në televizion. Është ngritur një komision për vlerësimin e aplikantëve sipas kriterëve. [RVV fq.17; 2.3; 2.5; 1.16, objektivi 6, fq. 24, M1; M3] [Kapitulli III Standardi IV.1]

2.2 Gjatë tre viteve të fundit, universiteti ka shënuar një numër të madh largimesh të stafit; për shembull, në vitin 2016-2017 u larguan 83 anëtarë të stafit akademik dhe u rekrutuan 63 të rinj. Mesatarisht, në secilin prej tre viteve, ka ndryshuar 58.2 për qind e stafit. Kjo nuk e mbështet synimin e universitetit për konsolidimin e mësimdhënies me cilësi të lartë. [M1; M2; M3] Kjo shpjegohet pjesërisht nga rritja e kërkesave të universitetit për kualifikime të larta të stafit të saj. Megjithatë, ka disa çështje të pashmangshme që lidhen me vazhdimësinë e lëvizjes së madhe të stafit. Drejtuesit pranojnë se ka largime dhe prurje të reja të stafit akademik, por nuk paraqesin shpjegime të mëtijshme për këtë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron këtë si **dobësi** dhe **rekomandon** që universiteti të vlerësojë ndikimin e lëvizjes së madhe vjetore të stafit akademik dhe të ndërmarrë veprimet e përshtatshme, për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. [196 fq.7, M1; M2; M3] [Kapitulli III Standardi IV.1]

2.3 Universiteti i ofron stafit akademik dhe personelit administrativ mundësi zhvillimi, të cilat ofrohen brenda universitetit ose jashtë tij, siç e kërkon roli i tyre. [2.6 a, b, c, d; 2.7] I gjithë stafi akademik dhe i kërkimit angazhohet në procesin e ofrimit të informacionit gjatë “Ditëve të Hapura”, në fillim të vitit të ri akademik, me qëllim ofrimin e një panorame sa më të gjerë të jetë e mundur për gjithçka që ofron universiteti. [2.8] Ministria organizon panairë edukimi, ku merr pjesë edhe universiteti. [M1; M2] Universiteti organizon aktivitete sociale, si promovime librash, tryeza të rrumbullakëta me aktorë të ndryshëm biznesi, për çështjet të aktualitetit, dhe me personalitete të ndryshme të fushës së shkencës ose artit. [RVV fq.18; 2.9] [Kapitulli III Standardi IV.2]

2.4 Secili anëtar i stafit akademik merr një vlerësim në fund të secilit vit akademik, dhe universiteti kryen një vlerësim përmbljedhës në fund të vitit, me ndihmën e Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. [1.17; 2.15] Këto vlerësime përfshijnë reagime nga studentët, nëpërmjet anketimeve online dhe fokus grupeve. [2.16] Studentët u shprehën se mësimdhënia dhe angazhimi i pedagogëve është i mirë. [Anketim i studentëve] [Kapitulli III Standardi IV.3]

2.5 Strategjia e zhvillimit e universitetit shënon si prioritet kualifikimin e mëtijshëm të stafit akademik. Departamenti i mësimdhënies organizon workshop-e dy herë në vit dhe stafi mësimdhënës nxitet të marrë pjesë në to. Workshop-i i metodologjisë së mësimdhënies i këtij viti iu kushtua ndryshimeve të metodave të vlerësimit. [M4; M12; M13] Universiteti promovon trajnimin e stafit të tij, duke u përqendruar në organizimin e konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me universitete të njohura të Evropës, ku njihen studimet bazuar në vlerësimin shkencor paraprak dhe të cilat botohen në një koleksion përmbljedhës ose “Punime” me numër ISBN. [2.10] Për stafin, që merr pjesë në veprimtari të ndryshme shkencore, si konferenca dhe botimi i teksteve të ndryshme akademike në formën e leksioneve ose librave të shtypur, ofrohet mbështetje financiare. [RVV fq.19; 2.13; 2.11; 2.14; M4; M12; M13] [Kapitulli III Standardi IV.3]

2.6 Stafi akademik nxitet t'i botojë rezultatet e kërkimit të tyre në revistën shkencore "OPTIME", e cila botohet dy herë në vit.[2.12] Dokumentet rishikohen nga kolegët, për të siguruar cilësinë. Profesorët dhe lektorët kanë të drejtën e lejes sabbatike deri në një vit për çdo shtatë vjet. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë në Evropë, dhe pjesëmarrja e pedagogëve të huaj si lektorë në leksione të hapura, workshop-e dhe konferenca shkencore, promovojnë zhvillimin profesional dhe ndarjen e përvojës në universitetet.[1.22; 1.29; 2.17] **[Kapitulli III Standardi IV.3]**

2.7 Veprimtaritë sociale organizohen në bashkëpunim me partnerë, si Kryqi i Kuq Shqiptar dhe Spitali Universitar, për të ndihmuar fëmijët jetimë dhe gratë e abuzuara. Universiteti mbështet gjithashtu disa aktivitete sportive, si futboll.[2.18] Universiteti i konsideron marrëveshjet e bashkëpunimit me universitetet e huaja si një mjet të domosdoshëm për njohjen e ndërsjelltë të kulturave dhe zhvillimin dhe shpërndarjen e njohurive shkencore.[1.16, objektivi 6, fq.24; 1.23] Kontratat e punës iu dorëzohen organeve qeveritare përkatëse, dhe nga të cilat çdo punëmarrës ka të drejtë të përfitojë në përputhje me legjislacionin.[RVV fq.19; 2.4; M5; M6; M11] **[Kapitulli III Standardi IV.4]**

2.8 Zyra e Burime Njerëzore koordinon dokumentimin e punëmarrësve në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe në përputhje me Statutin e universitetit mbledh dhe harton raporte statistikore me kërkesë të universitetit.[RVV fq.20; 1.9; 2.19; 2.4] **[Kapitulli III Standardi II.2]**

2.9 Shpërndarja e burimeve financiare është e efektshme; përdorimi i tyre caktohet mbi bazën e një programi financiar trevjeçar afatmesëm, të hartuar në përputhje me Standardet Shtetërore për arsimin e lartë. Burimet financiare të institucionit janë hartuar, duke marrë në konsideratë nevojat e zhvillimit normal të veprimtarive mësimore dhe kërkimore të universitetit. Procesi i hartimit të programit financiar fillon në muajin shtator dhe miratohet në muajin dhjetor të vitit paraardhës financiar.[1.1, neni 10, fq.6; 2.20] Gjatë hartimit dhe zbatimit të programit financiar, universiteti ndjek rregullat e ligjit për kontabilitetin, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, zbatimin e tij dhe të të gjitha rregullave të tjetra financiare dhe fiskale, sipas ligjeve dhe akteve, ligjore dhe nënligjore dhe rregulloreve të tjera në fuqi.[RVV fq.21; M4] **[Kapitulli III Standardi VI.1]**

2.10 Universitetit i është caktuar një buxhet vjetor në përputhje me programin financiar me bazë nevojat, i cili miratohet nga Bordi i Administrimit pas hartimit nga Rektori dhe diskutimit në mbledhjet e Senatit Akademik.[1.1, neni 10, fq.6; 2.20] Pas diskutimit, Departamenti i Financës harton buxhetin për zbatim dhe politikën e transparencës së shpërndarjes së buxhetit.[RVV fq.22; 2.21; M4] **[Kapitulli III Standardi VI.2]**

2.11 Veprimtaria financiare e universitetit është objekt i auditit në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe kërkesat e auditimit të raportimit financiar ndërkombëtar. Universiteti ka Zyrën e Auditit të Brendshëm. Pasqyrat financiare të universitetit bëhen publike çdo vit, së bashku me raportin e Auditit Ligjor, në përputhje me legjislacionin. Raporti i veprimtarisë financiare diskutohet në mbledhjet e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit.[1.2, neni 5, fq.6] Në të ardhmen, drejtuesit parashikojnë që treguesit e programit financiar dhe zbatimi i tij të ndahen dhe diskutohen me studentët, nëpërmjet Këshillit Studentor.[RVV fq.22; M4] **[Kapitulli III Standardi VI.3]**

2.12 Faqja e internetit e universitetit ofron informacion për publikun e gjerë, studentët dhe stafin, dhe përfshin: kalendarin akademik vjetor, oraret mësimore, oraret e sezoneve të provimeve, aktivitetet, takimet dhe mbledhjet e punës, eventet sociale, raportet e vetëvlerësimit, ofertën akademike, statutin, strukturën organizative, rregulloren e funksionimit.[Faqja e internetit, 2.22] Universiteti angazhon televizionin UTV, për promovimin e veprimtarive akademike dhe sociale, duke përfshirë informimin për ofertën

akademike dhe veprimtarinë kërkimore të ndërmarrë.**[RVV fq.23; M2; M6; M11; M12; M13]**
[Kapitulli III Standardi VII.1]

2.13 Zyrrave të universitetit iu kërkohet të ofrojnë informacion të detajuar për institucionin, duke ruajtur edhe konfidencialitetin për çështje specifike.**[2.1]** Brenda strukturave të universitetit përdoret sistemi intranet. Qëllimi i sistemit të informacionit është mbështetja, koordinimi dhe zhvillimi i stafit akademik, stafit ndihmës mësimor-shkencor, personelit administrativ dhe studentëve me anë të gamës së lehtësirave të mundësuar, nëpërmjet internetit si: laboratorë, arkiva elektronike dhe webmail-it. Është planifikuar prezantimi së shpejti i një sistemi të ri për bazën e të dhënave, me qëllim sigurimin e përdorimit më të mirë të të dhënave të universitetit. Ai synon të ofrojë shërbim më efikas, të gjerë dhe ndërveprues për stafin dhe studentët, duke përfshirë hedhjen e të gjitha të dhënave të studentëve, dhe si rrjedhojë të sigurojë analizë më të mirë për sjellë përmirësime.**[RVV fq.23; M2; M4; M6; M12; M13]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron prezantimin e sistemit të ri si aspekt pozitiv që duhet **pohuar**.**[Kapitulli III Standardi VII.1]**

2.14 Universiteti ka një rrjet efikas të teknologjisë së informacionit në të gjitha godinat e saj. Studentët mbështeten në kërkimin e tyre online nga stafi i bibliotekës, si edhe nga pedagogët e tyre, duke përfshirë përdorimin e bibliotekës online.**[M10; M12; M13]** Auditorët janë të mirëpajisur me pajisje audiovizive, si kompjutera dhe projektorë digjitalë, si dhe altoparantë me mikrofona në disa salla leksionesh.**[M10; M12; M13]** Shërbimi Wi-Fi është i disponueshëm në të gjitha ambientet. Studentët e vlerësojnë shumë ofrimin e teknologjisë së informacionit.**[Anketimi i studentëve]** Sallat e kompjuterave janë të pajisura me softuerët përkatës. Shumë pedagogë kanë mundësi të përdorin video si pikënisje të debatit dhe diskutimit për një temë mësimore. Universiteti nuk ofron programe të studimit në distancë.**[M10, RVV fq.24]** **[Kapitulli III Standardi VII.2]**

2.15 Universiteti ka një regjistër të pasurive të paluajtshme të tij, bazuar këto në kontrata përdorimi dhe qiraje.**[2.23]** Ai ka në administrim gjashtë godina me qëllim zhvillimin e procesit të mësimdhënies për vitin akademik 2016-2017:**[2.24, a,b,c]** Universiteti ka një masterplan për sigurinë, rehabilitimin, zgjerimin, dhe/ose ristrukturimin e pasurive të tij të paluajtshme. Projekti i ndërtimit të strukturës së re moderne pritet të miratohet në muajin shtator të vitit 2017. Ajo do të ndërtohet në qendër të qytetit, duke siguruar akses të lirshëm në godinat e tjera të universitetit. Ajo do të përmirësojë aksesin për studentët me aftësi të kufizuara dhe do të ndërtohet me qëllime mësimdhënieje. Universiteti menaxhon asetet e tij sipas një plani të përcaktuar, që synon përmirësimin e cilësisë së ambienteve mësimore dhe kërkimore. Kjo reflektohet në buxhetin vjetor të institucionit që i dorëzohet Ministrisë së Financave. UA ka punësuar arkitektë me kohë të plotë që merren me projektimin e projektit dhe mbikëqyrjen e kontratave të ndërtimit, rindërtimit dhe rikonstruksioneve pjesore.**[RVV fq.24; M4; M11]** **[Kapitulli III Standardi VII.3]**

2.16 Zyra e Arkivit dhe Protokollit ruan regjistra dhe arkiva, si dhe klasifikon koleksionin arkivor dhe dokumentues të trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore. Arkiva e tij administrohet dhe funksionon në përputhje me legjislacionin.**[M15; 2.25]** Përditësimi i arkivit të tij realizohet edhe me anë të përfshirjes së televizionit UTV. Të gjitha veprimtaritë akademike dhe kërkimore të institucionit arkivohen në mënyrë elektronike për referencë dhe për t'u aksesuar nga brezat e ardhshëm.**[M11]** **[kapitulli III Standardi VII.4]**

2.17 Universiteti ka organizuar aktivitete si: promovimi i librave të personaliteteve të tij akademike, panairë librash, ekspozita të ndryshme, si dhe ceremoni nderimi për figurat e tij akademike. Universiteti ka shtëpinë botuese "Albanian University Press", e cila mbështet veprimtarinë e saj. Universiteti ndjek politikën e vlerësimit dhe zhvillimit të trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore, nëpërmjet dhënies së titujve "Honoris Causa" nga Senati Akademik.**[2.26]** **[Kapitulli III Standardi VII.4]**

2.18 Infrastruktura e universitetit ofron kushte të përshtatshme dhe bashkëkohore për zhvillimin e veprimtarive akademike dhe administrative ditore, si: ambiente për stafin akademik dhe personelin administrativ; sekretarinë mësimore; salla leksionesh; salla; laboratorësh; ambiente të senatit; salla audiovizive; salla kompjuterash; salla konferencash; biblioteka; ambiente shërbimi për palë të treta; dhe ambiente sportive. Secili anëtar i stafit akademik ka vendin e tij të punës në një zyrë ose mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e veprimtarisë së tij mësimor dhe kërkimore. Sallat janë të mirëpajisura. Izolimi nuk është shumë i mirë në disa godina, dhe si rrjedhojë, shpeshherë disa studentë ankohen për ambiente të ftohta. Burimet fizike për programet e stomatologjisë janë të mira dhe ndihmojnë në mësimdhënie dhe kërkim. Gjatë turit në ambientet e universitetit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi edhe klinikën dentare. Klinika disponon burimet e duhura. Klinika dentare ka në dispozicion, për përdorim nga ana e studentëve, 70 hapësira të cilësisë së mirë për kirurgji me ndenjese, e cila është **praktikë e mirë.**[Anketimi i studentëve 2.28; M10] Kjo iu mundëson studentëve të fitojnë përvojë të mirë për punën me pacientët, duke u mbështetur edhe nga pedagogët e tyre. Në departamente të ndryshme ka ambiente të ndryshme për biblioteka, me shërbime të ndryshme si libra, revista dhe teknologji informacioni. Megjithëse aksesit në internet është i mirë, studentët kanë pak akses në teknologjinë e informacionit, përveçse kur sjellin me vete laptopët e tyre, dhe në përgjithësi e konsiderojnë punën e bibliotekës si jo shumë të mirë. Reagimet e studentëve mbledhen si pjesë e mbledhjes së reagimeve të tjera të studentëve dhe analizohen nga Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (shihni gjithashtu pikën 5.7).Kuadri i marrëveshjes ndërmjet universitetit dhe “Albanian College” në Tiranë iu mundëson studentëve përdorimin e ambienteve sportive për basketboll, volejball, tenis, dhe palestrës; megjithatë, vetëm gjysma e studentëve mendojnë se ofrimi i ambienteve sportive të brendshme dhe/ose të jashtme është i mirë ose shumë i mirë.[2.29; M10; Anketimi i studentëve] [Kapitulli III Standardi VII.5]

2.19 Universiteti ka një strukturë administrative të logjistikës për kryerjen e funksioneve të interesit të përbashkët. Për shembull, Klinika Universitare, me mbështetjen e personelit vendas dhe atij të huaj, ofron shërbime mjekësore për palët e treta. Shtëpia botuese “Albanian University Press” mbështet të gjithë veprimtarinë botuese, jo vetëm të stafit dhe të studentëve, por të të gjitha palëve të interesit në mbarë vendin. Universiteti ka një marrëveshje bashkëpunimi me televizionin UTV, për ofrimin e shërbimeve të informimit për palët e treta.[M11] [Kapitulli III Standardi VII.6]

2.20 Universiteti e ushtron veprimtarinë e tij në gjashtë godina të dedikuara për veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, ndërsa administrimi i tyre është në përputhje të plotë me kërkesat e higjienës dhe kërkesat për rreziqet mjedisore.[2.27] Shumica e godinave janë të izoluar; pjesa më e madhe e dritareve janë me dopio xham dhe ruajnë temperaturën e njëtrajtshme dhe siguron një ambient të qetë. Universiteti i ruan dhe i rinovon vazhdimisht ambientet që kanë probleme me izolimin. Megjithatë, një pakicë e konsiderueshme e studentëve nuk e klasifikojnë temperaturën e ambienteve si një aspekt të mirë ose më të mirë.[RVV fq.24; Anketimi i studentëve] [Kapitulli III Standardi V.1]

2.21 Infrastruktura e universitetit ofron lehtësira të teknologjisë së informacionit për stafin mësimdhënës dhe personelin administrativ. Për të mbështetur punën e universitetit, përdoren një larmi laboratorësh, të përshtatshëm sipas lëndës, ambiente bibliotekë, salla me pajisje audiovizive, salla kompjuterash dhe salla konferencash, megjithëse një laborator farmacie nuk është i pajisur mirë për punën që bën, duke mos pasur pajisje qelqi dhe substanca kimike.[M10; 2.24, 2,28] Universiteti përmbush normën e sipërfaqes së përdorshme me një sipërfaqe mesatare prej 5.4 m²/student në të gjitha godinat. Për programet e studimit të inxhinierisë, arkitekturës ose mjekësisë, janë ndjekur normat e përmendura më sipër dhe në disa raste ato pothuajse janë dyfishuar.[2.24, b,c] [Kapitulli III Standardi V.1]

2.22 Universiteti ka marrëveshje për praktikën profesionale të studentëve me institucione qeveritare dhe private, si Arkivi Kombëtar, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Agjencia e Shërbimeve të Sportit, dhe Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” dhe këto rrisin përvojën e mirë praktike.**[1.25] [Kapitulli III Standardi V.1]**

2.23 Stafi është udhëzuar se si të marrë masat e duhura në rast rënie zjarri.**[2.30]** Universiteti ka certifikata mbrojtjeje nga zjarri në pesë prej gjashtë ambienteve të tij dhe ka një sistem mbrojtjeje nga shkarkimet elektrike. Universiteti ka burime alternative për furnizimin me energji elektrike, si edhe rezerva të mjaftueshme uji, që mundësojnë ofrimin e pandërprerë të energjisë elektrike dhe ujit.**[2.22; 2.27]** Megjithatë, vetëm një pakicë e vogël e studentëve besojnë se ka akses të mirë ose shumë të mirë në ashensorë ose në shkallët e emergjencës. Aksesit për studentët me aftësi të kufizuara është i kufizuar; më pak se gjysma e studentëve mendojnë se aksesit për personat me aftësi të kufizuara është i mirë, megjithëse ka projekt për përmirësimin e aksesit në godinën e re të planifikuar për t’u miratuar në muajin shtator të vitit 2007.**[M10; M15; Anketimi i studentëve] [Kapitulli III Standardi V.1]**

2.24 Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave të studentëve zhvillohen në mënyrë konfidenciale dhe në përputhje me kërkesat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Zyra e Arkivit dhe Protokollit është departamenti përgjegjës për ruajtjen e dokumentacionit të të gjitha veprimtarive të rëndësishme të universitetit. Dokumentacioni ruhet dhe mbahet në format të shtypur dhe në atë elektronik. Ka gjithashtu një bazë të dhënash për regjistrimin e studentëve, numrin e matrikullimit dhe të dhënat personale. Këto të dhëna depozitohen në departamentet përkatëse. Procesi i informimit dhe regjistrimit të studentëve të rinj kryhet nga Zyra e Regjistrimit, Transferimit dhe Ekuivalentimit të Studimeve.**[RVV fq. 27; M1; M4; M2; M3] [Kapitulli III Standardi V.2]**

2.25 Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit është i disponueshëm në faqen e internetit, si dhe nëpërmjet broshurave që përmbajnë informacion për të gjitha programet e studimeve. Procedurat dhe kriteret e detajuara të transferimit përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të universitetit, Rregulloren e Transferimit të Studentëve **[2.32]** dhe rregulloret e fakultetit. Pranë Zyrës së kryesekretarit të fakulteteve gjenden për çdo program studimi regjistrat themeltarë në format të shtypur dhe elektronik, të cilët përmbajnë të dhënat personale dhe numrin e matrikullimit së studentëve. Sekretaria e Përgjithshme e universitetit është përgjegjëse për përpunimin dhe ofrimin e të dhënave statistikore, qoftë për një vit ose për shumë vite, sipas kërkesave të institucionit dhe Ministrisë.**[M4] [Kapitulli III Standardi V.2]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- ofrimin e 70 hapësirave të cilësisë së mirë për kirurgji me ndenjësë, për përdorim nga studentët në klinikën dentare (pika 2.18; **Kapitulli III Standardi VII.5**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- largimin e një numri të madh pedagogësh gjatë tre viteve të fundit (pika 2.2; **Kapitulli III Standardi IV.1**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- vlerësimin nga ana e universitetit të ndikimit të lëvizjes së madhe vjetore të stafit dhe marrjen e masave të përshtatshme (pika 2.2; **Kapitulli III Standardi IV.1**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e ndërmarrë si më poshtë:

- prezantimin e softuerit të ri të teknologjisë së informacionit (pika 2.13; **Kapitulli III Standardi VII.1**).

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 Universiteti ofron programe në të tre ciklet e studimit të Bolonjës. Këto programe zhvillohen në mënyrë të suksesshme që prej themelimit të universitetit në vitin 2004. Në përputhje me strategjinë e tij të zhvillimit, përfshihen edhe programet shëndetësore dhe shkencat shoqërore. **[RVV fq.30]** Aktualisht, programet e nivelit doktorat nuk janë kredituar, ndërsa gjatë kryerjes së vizitës, universiteti ishte në pritje të vendimit. **[1.17, Raport vlerësimi, 2015-16]** Programet e studimit janë hartuar në mënyrë të tillë që të nxisin zhvillimin e studentëve si “qytetarë të denjë të përgatitur për tregun e punës ... që në të njëjtën kohë nxisin, nëpërmjet kontributit të tyre, zhvillimin e qëndrueshëm në shoqëri të karakterizuar nga vlerat qytetare dhe integriteti”. **[RVV fq.31]** Universiteti kryen studime tregu para hapjes së programeve të reja, për të siguruar se ato lidhen me nevojat e tregut të punës, dhe në shtator të vitit 2016 u mor një vendim për kryerjen e analizave të tregut të punës për të gjitha departamentet. **[4.7] [Kapitulli I Standardi I.1]** Universiteti ka një plan ambicioz për ofrimin e disa prej programeve të tij të studimit në gjuhën italiane, si dhe në gjuhën shqipe. Programi i parë prej tyre është miratuar së fundmi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. **[M1]**

3.2 Programet e universitetit promovohen në mënyrë aktive për ata që kanë braktisur shkollën dhe për të tjerë, nëpërmjet faqes së tij të internetit, që është e disponueshme në gjuhën shqipe dhe angleze, lajmeve në televizion (sipas një marrëveshjeje formale me UTV), medias sociale dhe takimeve me maturanët e shkollës së mesme. **[3.1; 3.5b; 2.2]** Përdorimi novator i televizionit dhe medias sociale për reklamimin e programeve dhe ditëve të hapura të universitetit për audiencat e synuara konsiderohet si **praktikë e mirë**. Manifesti Akademik dhe Manuali i Studentëve, **[3.5a; 5.4]** që janë të disponueshëm në faqen e internetit, shërbejnë si burime informacionesh të detajuara për programet e studimit të universitetit dhe përfshijnë informacion të përgjithshëm për misionin e universitetit, kalendarin akademik dhe rregulloret akademike, sistemet e përdorura për vlerësimin me notë, detaje për secilin departament akademik, një listë të programeve të studimit në të tre nivelet e studimeve, si dhe ambiente sociale dhe të tjera. Kriteret e pranimeve janë të publikuara në faqen e internetit. **[3.7, fotografi e ekranit e faqes së internetit të AU; AE5a-d]** Studentët pohuan për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm se kishin vështirësi në gjetjen e informacionit për programet e tyre të studimeve, ndërsa metodat e përdorura të vlerësimit i konsideronin si të drejta dhe të përshtatshme. **[M5] [Kapitulli I Standardi I.1]**

3.3 Universiteti ofron vetëm programe me kohë të plotë. Zhvillimi **[RVV fq.30]** i edukimit në vazhdim është një objektivi strategjik. Aktualisht organizohen veprimtari në formën e workshop-eve për profesionistët e shërbimit shëndetësor. Universiteti ka një politikë që mundëson transferimin e krediteve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve në institucione të tjera, qofshin këto universitete ose shoqata profesionale. **[2.32]** Megjithatë, kjo nuk përfshin mundësinë e fitimit të krediteve nga të mësuarit nëpërmjet përvojës. **[Kapitulli I Standardi I.2; Kapitulli I Standardi I.7]**

3.4 Propozimet për programe të reja ndërmerren në nivel departamenti dhe zhvillohen në bashkëpunim me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave. Kjo zyrë u ngrit në vitin 2008 dhe i raporton drejtpërdrejt Rektorit. **[1.2 neni 14; 3.9]** Më pas, propozimet i dërgohen fakultetit përkatës për miratim, ndërsa miratimi përfundimtar jepet nga Senati Akademik. **[AE1a-c]** Kurrikulat që u vunë në dispozicion Grupit gjatë vlerësimit të jashtëm treguan se vëmendje e veçantë i ishte kushtuar hartimit dhe koherencës logjike, përmbajtjes ndaj strategjisë së zhvillimit të universitetit. **[3.3; 1.16]** Më pas, kurrikulat integrohen në rregullore (specifikime të programit). **[3.2]** Këto tregojnë kërkesat për përfundimin e suksesshëm të programit të studimit. Syllabuset për kurset individuale zhvillohen sipas një modeli standard që rendit rezultatet e mësimit, temat për t'u trajtuar, metodologjinë e mësimit dhe metodat e vlerësimit që duhen përdorur krahas literaturës së rekomanduar. **[3.8]** Metodatat e

vlerësimit i nënshtrohen rishikime të vazhdueshme, me qëllim përputhjen e tyre me objektivat e kursit. **[M11] [Kapitulli I Standardi I.3]**

3.5 Universiteti ka metodologji të pasur për vlerësimin vjetor të programeve, i cili udhëhiqet nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave. **[1.1 Neni 18; M4]** Ndryshimet ndërmerren në nivel departamenti, zakonisht në fund të vitit akademik, dhe miratohen nga Këshilli përkatës i fakultetit. **[AE1a-c]** Raporti vjetor i hartuar nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave rendit ndryshimet që i janë bërë kurrikulave të posaçme. Pedagogët e ngarkuar me kurse individuale bëjnë rregullisht përditësime të literaturës dhe temave. **[M1; 4.1 passim, Dok. shitesë Raport Vjetor] [Kapitulli I Standardi I.4]**

3.6 Strategjia e Zhvillimit Institucional **[1.16]** i kushtohet një programi ambicioz inovacioni në arsimin e lartë me qëllim përmbushjen e kërkesës në Shqipëri për një institucion që i përgatit studentët për botën e globalizuar. **[4.7]** Kurrikulat janë zhvilluar, për të qenë multidisiplinore, dhe përfshijnë mësimnxënien e gjuhës angleze dhe gjuhëve të tjera të huaja. **[3.2]** Disa departamente ftojnë rregullisht lektorë të huaj. **[1.22] [Kapitulli I Standardi I.4]**

3.7 Ngarkesa mësimore përcaktohet me detaje për secilën kategori stafi, dhe ofrojnë tryeza diskutimi për lloje të ndryshme veprimtarish në një format standard. Për stafin e angazhuar me veprimtarinë kërkimore parashikohet lehtësim nga ngarkesa mësimore. **[3.4]** Gjatë tre viteve të fundit, ka pasur shumë largime të stafit akademik, edhe pse Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk gjeti prova se kjo ndikonte drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies. Secili anëtar i stafit akademik vlerësohet në fund të vitit akademik nga përgjegjësi i departamentit ku bën pjesë, si dhe ka një sistem të vëzhgimit të mësimdhënies. **[M2]** Për mbledhjen e informacionit për rezultatet e kërkimit dhe performancën e mësimdhënies përdoret një formular standard. **[2.15]** Krahas kësaj, pritet që pedagogët të plotësojnë një raport në fund të secilit kurs që ata zhvillojnë. Kjo përfshin reflektimin nëse kursi i ka arritur objektivat e tij të mësimnxënies dhe kërkon ndërmarrjen e ndryshimeve. Shumë prej anëtarëve të stafit akademik kanë përvojë ndërkombëtare, të cilën e reflektojnë në mësimdhënien e tyre. Dy herë në vit organizohen kurse për metodologjinë e mësimdhënies. **[M3; M12; M13]** Pavarësisht shkallë së gjerë të largimit të stafit, këto marrëveshje lehtësojnë ruajtjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. **[Kapitulli I Standardi I.5]**

3.8 Kërkesat e pranimit, programet e studimit, duke përfshirë objektivat mësimore, kurrikulat, sasia e krediteve dhe informacione të tjera përkatëse përfshihen në rregullore dhe syllabuse për secilin nga programet e studimit. **[AE1-AE3]** Informacioni i përgjithshëm për aspektet akademike, duke përfshirë politikat dhe rregulloret për integritetin akademik, përfshihet në Manualin e Studentëve, i cili është i disponueshëm në faqen e internetit të universitetit. **[5.4; AE3.7]** Informacioni ndahet gjithashtu me studentët nga pedagogët dhe zyrat e departamenteve gjatë javëve të para të kurseve të tyre. **[RVV fq.32] [Kapitulli I Standardi I.6]**

3.9 Secili program i ciklit të parë të studimeve zhvillohet brenda një kuadri që evidenton llojet e ndryshme të aftësive që kërkojnë studentët, duke përfshirë njohuritë bazë, metodat e përgjithshme shkencore dhe parimet e njohuritë lidhur me fushën specifike të studimit. Kuadri përcaktohet qartësisht në rregulloret e secilit program. **[E2a1]**

3.10 Universiteti demonstroi angazhim të madh për mbështetjen e studentëve. Kjo arrihet nëpërmjet punës së zyrave të universitetit, përkatësisht Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe Zyrës së Karrierës dhe Alumnit. **[RVV fq.33; faqja e internetit e AU]** Këto zyra punojnë në bashkëpunim me zyrat e fakultetit dhe departamenteve, si dhe me Këshillin Studentor, për të mundësuar marrjen e këshillave dhe mbështetjes së duhur nga ana e studentëve. Sekretaria Mësimore e universitetit, që ofron

shërbime regjistrimi për të gjithë fakultetet, monitoron ecurinë e secilit student, procesin e provimit dhe vlerësimit, dhe lëshimin e të diplomave. **[Faqja e internetit e AU][Kapitulli I Standardi I.8]**

3.11 Metodatat e mësimdhënies janë përgjegjësi e secilit pedagog në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit të tyre. Syllabuset për secilin kurs, që u vlerësuan gjatë vizitës, pohuan se përdorëshin një gamë e gjerë metodash të mësimdhënies, të cilat ishin të lidhura me objektivat e mësimdhënies të përcaktuara për kursin. **[p.sh. E3c1]** Të gjithë studentëve të ciklit të parë iu kërkohet të zhvillojnë stazhin ose praktikën profesionale në një institucion/organizatë jashtë universitetit. **[4.2a; 4.2c]** Të paktën 70 për qind e ngarkesës mësimore në ciklin e parë zhvillohet nga stafi akademik me kohë të plotë. **[RVV fq.33]** **[Kapitulli I Standardi I.8]**

3.12 Programet e ciklit të dytë ndahen në dy lloje. Programet e Masterit të Shkencave janë dyvjeçare dhe janë hartuar në mënyrë të tillë që t'iu përshtaten prioriteteve kërkimore të universitetit. **[p.sh. E2c2]** Diplomat e Masterit Profesional kanë 90 kredite ECTS të ndara në tre semestra, dhe synojnë përgatitjen e studentëve në mënyrë më të drejtpërdrejtë për punësimin. **[p.sh. E2b1]** Gjatë përgatitjes së programeve të tilla kërkohet ndihmë dhe këshilla nga punëdhënësit të përshtatshëm të ardhshëm. **[RVV fq.34; 3.9; 1.25]** Pritet që studentët e ciklit të dytë të realizojnë projekte që i shkathësojnë ata me aftësi kërkimore praktike, të cilat mund të shfrytëzohen në vendin e punës, si dhe të dorëzojnë tezën e tyre të diplomës. Atyre iu jepen udhëzime të qarta për mënyrën e përgatitjes së tezës. **[3.10c1-4; M6; M8]** **[Kapitulli I Standardi I.9]**

3.13 Në përputhje me strategjinë e tij të zhvillimit institucional, universiteti pohon objektivin e tij të nxitjes së mobilitetit të studentëve në Evropë dhe në vende të tjera. **[RVV fq.35; 1.16]** Të gjitha programet e tij të diplomimit janë konceptuar në bazë të parimeve të Bolonjës dhe kanë kreditet e duhura ECTS. Universiteti i pajis ata me diplomë dhe suplementin e diplomës në gjuhën angleze dhe atë shqipe. Studimi i gjuhës angleze është pjesë e kurrikulës në kurset e ciklit të parë. Studentët e programeve të ciklit të dytë dhe të tretë duhet të bëjnë provimin e gjuhës angleze të njohur ndërkombëtarisht. **[RVV fq.35]** Ai ofron gjithashtu kurse të mësimi të gjuhës shqipe për studentët e tij të huaj. Aktualisht, universiteti ka marrëveshje me një sërë universitetesh në Evropë dhe më gjerë. **[1.23; 2.14a-b]** Ai po harton një politikë për të siguruar që programet e tij të studimit të ofrohen edhe në gjuhën italiane (shihni pikën 1.6). **[M1; M3]** **[Kapitulli I Standardi I.10]**

3.14 Të gjitha programet e universitetit janë hartuar në mënyrë të tillë që jo vetëm të integrojnë njohuritë teorike të ngulitura nëpërmjet metodave tradicionale të mësimdhënies, por edhe mundësinë e vënies në praktikë të këtyre njohurive, fal punës laboratorike, detyrave kërkimore dhe praktikave profesionale. **[AE1-3, passim]** Programet e studimit përfshijnë kërkesën për përgatitjen e tezës së diplomës (shihni pikën 3.12). Pjesëmarrja e studentëve në veprimtari ekstrakurrikulare, si klube dhe konferenca të ndryshme, përkrahet edhe nga universiteti. Këto lidhen në veçanti me fusha specifike të studimit në universitet, si stomatologji, drejtësi, art dhe dizajn, që parashikojnë përgatitjen e studentëve për karrierën e tyre profesionale. **[3.16 video që nuk është parë; <http://albanianuniversity.edu.al/en/student-clubs/>]** **[Kapitulli I Standardi I.11]**

3.15 Programet e studimit përfshijnë kurse në fusha që lidhen drejtpërdrejtë me punësimin. Ato janë hartuar në përputhje me nivelin dhe fushën specifike të studimit. Praktika profesionale ofron mundësi shtesë për zhvillimin e aftësive për punësim dhe krijimin e kontakteve të dobishme (shihni gjithashtu pikën 1.11). **[M1]** Ruhen statistika lidhur me faktin se sa mundësi kanë pasur studentët për t'u punësuar në pozicione që lidhen drejtpërdrejt me fushën e tyre të studimit, edhe pse të dhënat e ofruara nuk janë të plota (shihni gjithashtu pikën 1.9). Zyra e Karrierës, Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët ofron mbështetje për studentët gjatë aplikimit të tyre në vende pune. Studentët i kanë

mirëpritur mundësitë që iu janë dhënë për krijimin e kontakteve me profesionistë të fushave të tyre.[3.12; M4; M5] [*Kapitulli I Standardi I.12*]

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- përdorimin novator të televizionit dhe medias sociale për reklamimin e programeve dhe ditëve të hapura të universitetit për audiencat e synuara (pika 3.2; *Kapitulli I Standardi I.1*).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

4.1 Programet e studimit hartohen fillimisht nga departamentet akademike, dhe më pas miratohen nga strukturat drejtuese të universitetit. Zbatimi i tyre bëhet në nivel departamenti. Dokumentimi i programeve të studimit dhe planeve mësimore është përgjegjësi e departamenteve akademike në përputhje me kërkesat e Zyrës së Kurrikulave.**[3.3]** Programet e studimit mbahen gjithmonë nën shqyrtim nga departamentet akademike dhe nga pedagogët, edhe pse kjo nuk është një praktikë që ndiqet për të gjitha programet e studimit dhe nga të gjithë fakultetet. Universiteti ka kapacitetin për zhvillimin e praktikave mësimore dhe pedagogjisë. Ai ofron dokumentacionin e nevojshëm për programet e tij të studimit, të cilat përditësohen vazhdimisht.**[1.2; 3.2]** Ai mbikëqyr arsimimin teorik, praktik dhe profesional të studentëve në secilin prej programeve të tij të studimit. Në fund të procesit mësimor, studentët marrin nota dhe kredite në përputhje me Procesin e Bolonjës.**[4.1; 4.2; 3.2]** Universiteti monitoron praktikën profesionale, punën laboratorike dhe punën praktike të specializuar, si praktika dentare. Kjo e fundit në Fakultetin e Mjekësisë, konkretisht në Departamentin e Stomatologjisë, ofrohet në kushte të përshtatshme dhe me pajisje të mira (shihni gjithashtu pikën 2.18).**[M10] [Kapitulli I Standardi II.1]**

4.2 Universiteti i pajis studentët, që i kanë përmbushur të gjitha detyrimet e programit të studimit, me diplomën përkatëse, e cila është një dokument zyrtar. Universiteti ka rregulla dhe procedura të qarta për të siguruar përmbushjen e kërkesave nga ana e studentëve në çdo nivel studimi. Ky proces është i rregulluar dhe i dokumentuar. Leksionet alternohen me punën praktikë. Studentët penalizohen për mosndjekjen e leksioneve dhe seminareve. Kjo temë ka qenë shpesh objekt diskutimi në mbledhjet e Rektoratit, duke nxjerrë në pah pranimin e çështjeve të tilla.**[C.15; M1]** Në Fakultetin e Mjekësisë, studentët punojnë drejtpërdrejt me pacientët në klinika ose struktura në sektorin e shërbimeve. Të gjithë studentët dhe stafin akademik janë njohur me Rregulloret. Provimet zhvillohen dhe vlerësohen në mënyrë anonime, dhe rezultatet shpallen pas shtatë ditësh.**[115; AE2a2]** Vlerësimi i studentëve përbëhet nga disa elemente, duke përfshirë ndjekjen e leksioneve dhe seminareve, detyrat e kursit, dhe provimet përfundimtare.**[M1; M7]** Rezultatet e provimeve mund të ankimohen, nëpërmjet një kërkesë me shkrim drejtuar sekretariatit.**[3.2]** Universiteti lejon transferimin e krediteve me një kufi të caktuar, pranon transferimet e studentëve, dhe iu jep studentëve mundësinë e zhvillimit të provimeve ose përmbushjes së detyrimeve të tyre në universitete të tjera. Është krijuar edhe një Shkollë Doktorature, por programet e saj nuk janë akredituar ende. Situata aktuale lidhur me mungesën e akreditimit të programit doktorat, ku disa studentë vazhdojnë aktualisht studimet e tyre konsiderohet si **dobësi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** ndjekjen e hapave nga universiteti për gjetjen e një mënyre për kualifikimin e të gjithë studentëve të regjistruar (shihni gjithashtu pikën 1.8) **[Kapitulli I Standardi II.2]**

4.3 Cilësia e programeve të studimit dhe e mësimdhënies vlerësohen vazhdimisht nga departamentet. Secili pedagog plotëson një raport vjetor për veprimtarinë e tij ose të saj gjatë vitit, duke përfshirë kërkimin, dhe këto i përcillen Dekanit të Fakultetit.**[4.5; 4.6, Deklaratë për veprimtarinë kërkimore]** Studentët plotësojnë pyetësorë lidhur me programin ku studiojnë dhe cilësinë e mësimdhënies, megjithëse nuk përmban pyetje që lidhen me përmirësimin e programeve të studimit. Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë analizon reagimet dhe i mbështet masat për përmirësim, dhe janë hartuar plane të qarta veprimi. Përgjegjësit e departamenteve iu komunikojnë stafit pikëpamjet e studentëve, dhe pritjet të bëhen përmirësime, ndërkohë që pedagogëve iu ofrohet mbështetje për realizimin e përmirësimit. Nëse nuk vërehen përmirësime, kontrata e tyre nuk rinovohet.**[M4; M10; M11]** Grupet e posaçme në nivel departamenti janë përgjegjëse për vlerësimin e kurrikulës dhe syllabusit, edhe pse evidencat sugjerojnë se numri i ndryshimeve që janë realizuar është

mjaft i kufizuar.[4.3; 4.4; 4.7; 1.13] Studentët kanë mundësi të japin kontributin e tyre në këto diskutime, nëpërmjet përfaqësimit dhe nëpërmjet Këshillit Studentor.[M6; M7]

4.4 Nivelet e punësimit të të diplomuarve monitorohen në disa fusha studimi, si për shembull në stomatologji, arkitekturë dhe farmaci.[M4; M15] **[Kapitulli I Standardi II.3]**

4.5 Universiteti synon të rrisë cilësinë e mësimdhënies, nëpërmjet ofrimit të trajnimit të stafit akademik në fushat e metodologjisë dhe metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe kërkimit.[2.6] Trajnimi zhvillohet me metoda të reja ndërvepruese të mësimdhënies, ku në qendër të tyre është studenti.[M3] Cilësia përmirësohet nëpërmjet shkëmbimit të përvojës dhe mësimdhënies nga pedagogë të huaj. Kjo praktikë është ndjekur vetëm në disa njësi kryesore, kryesisht në Fakultetin e Mjekësisë.[1.29] Brenda secilit departament, pedagogë të caktuar janë përgjegjës për sigurimin e cilësisë, dhe për këtë qëllim mbajnë lidhje me Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Rektoratit.[M11; M12] **[Kapitulli I Standardi II.4]**

4.6 Fakultetet janë të organizuar në departamente, ku secili prej tyre, në përputhje me legjislacionin qeverisës, ka të paktën shtatë anëtarë të stafit akademik.**[Ligji për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë; 1.1; 2.1]** Departamenti i Stomatologjisë ka një numër të madh pedagogësh, dhe si rrjedhojë, është i ndarë në njësi më të vogla, për sa i përket mësimdhënies dhe kërkimit.[M11; M12] Departamentet e tjera nuk kanë struktura të tilla funksionale, dhe si rrjedhojë, nuk mund të ofrojnë dëshmi të zyrta të pikave të forta dhe pikave të dobëta të veprimtarisë së tyre kërkimore dhe shkencore. Në universitet nuk ka grupime qëllimi i të cilave të jetë vetëm kërkimi, megjithëse sipas Statutit dhe Rregullores së tij, është departamenti ai që e ka këtë përgjegjësi.[1.1; 1.2] Universiteti ka nënshkruar së fundmi 12 marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi me universitetet në Shqipëri dhe jashtë vendit. Universiteti pranon se ka një nivel të ulët të angazhimit të studentëve në veprimtari kërkimore në ciklin e dytë dhe të tretë.[1.25, referencë 1.12] **[C15; M1] [Kapitulli II Standardi I.2; Kapitulli II Standardi I.6]**

4.7 Kërkimi është më tepër një veprimtari e ndërmarrë në mënyrë individuale nga pedagogët sesa një përgjegjësi e organizuar e departamenteve.[M4; M11; M12] Universiteti ka një zyrë kërkimi që koordinon në mënyrë administrative projektpropozimet për secilin departament dhe përcakton kërkesat e tyre për financim. Zyra harton dhe ia dorëzon propozimet Senatit Akademik për miratim.[M3; M11] Rezultoni që disa departamente kanë ndërmarrë shumë pak projekte kërkimore të rëndësishme. Ka edhe disa përjashtime, si dega e Implantologjisë së Stomatologjisë dhe Departamenti i Arkitekturës, i cili ka ndërmarrë një projekt urban për vlerësimin e godinave të ndërtuara para viteve 1990.[M8; M10] Ky i fundit ka përfshirë një numër të konsiderueshëm studentësh. Një departament tjetër është angazhuar në një projekt bashkëpunimi me një universitet italian. Megjithatë, numri i projekteve kërkimore, ku angazhohet universiteti është i ulët krahasuar me numrin e stafit akademik dhe të studentëve, dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron këtë si **dobësi**. Ai i **rekomandon** universitetit miratimin e një qasjeje strategjike për zhvillimin e kërkimit dhe miratimin e një plan veprimi. Disponohen laboratorët në disa departamente për mësimdhënien, por zakonisht nuk përdoren për veprimtarinë kërkimore.[M6; M10; M11] Universiteti ka aplikuar për fonde nga Bashkimi Evropian, në bashkëpunim me universitete të tjera.**[Kapitulli II Standardi I.1; Kapitulli II Standardi I.4; Kapitulli II Standardi I.6]**

4.8 Universiteti ka marrë pjesë në disa konferenca ndërkombëtare në Selanik, Greqi dhe në Itali.[M11; M12] Ai ka nënshkruar së fundmi marrëveshje të reja bashkëpunimi, edhe pse disa prej tyre janë në fazë fillestare dhe nuk janë vënë ende në praktikë.[1.27] Janë organizuar seanca informimi, për shembull për pranimin në Bashkimin Evropian dhe Horizon 2020 dhe Erasmus+, por deri më tani nuk janë organizuar mbledhje ceremoniale, për prezantimin e rezultateve të veprimtarisë kërkimore të universitetit. Stafi akademik ka botuar

dokumente dhe artikuj në revistën shkencore të universitetit. [M4; M11] [*Kapitulli II Standardi I.3*]

4.9 Prioritetet e universitetit lidhen me specifikat e fushave që mbulohen nga programet e studimit dhe diplomat e tij. Departamentet nuk kanë përqendrim të qartë dhe gjithëpërfshirës të veprimtaria kërkimore, gjë që përbën **dobësi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që universiteti të qartësojë dhe të zbatojë prioritetet e tij të kërkimit. Është kryer një analizë vjetore e veprimtarisë kërkimore. [M11; M12] Strategjia e zhvillimit identifikon disa prioritete, por ato nuk janë shprehur qartë në lidhje me kërkimin. [18; 1.16] Universiteti deklaron se ai përkrah “kërkimin në fusha prioritare, nëpërmjet leksioneve të hapura, seminareve dhe tryezave të rrumbullakëta”, por duhet bërë akoma më shumë për t’i dhënë më tepër rëndësi kësaj. [RVV; M3] Ndonëse bashkëpunimi me institucione të tjera kombëtare në fushën e kërkimit ka qenë i kufizuar, po bëhen përpjekje për zhvillimin e tij; përfshirja dhe bashkëpunimi i studiuesve të huaj është i mirëpritur. [M11; M12] Përgjithësisht, universiteti nuk përfshihet në projekte me karakter rajonal dhe kombëtar. [M11; M12; RVV fq.43] Buxheti për kërkimin është i kufizuar. Universiteti ka një buxhet të përcaktua për çdo student, por pjesa më e madhe tij përdoret për veprimtaritë e mësimdhënies. [M3; M4; 196] [*Kapitulli II Standardi I.4; Kapitulli II Standardi I.5; Kapitulli II Standardi I.6*]

4.10 Që prej vitit 2012, universiteti ka organizuar gjithsej 30 konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe mundëson botimin e rezultateve të tyre. Kjo realizohet nëpërmjet revistës së tij akademike, “OPTIME”, shtëpisë së tij botuese, “AU Press”, dhe stacioneve televizive, veçanërisht “UTV News”. Botimet e stafit promovohen në panairët e librit të organizuara në Shqipëri. [3.2; RVV fq.43; M12] [*Kapitulli II Standardi I.7; Kapitulli II Standardi I.8*]

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesën e akreditimit të programit doktorat, ku aktualisht disa studentë vazhdojnë studimet e tyre (pika 4.2; *Kapitulli I Standardi II.2*)
- numrin e pakët të projekteve, ku angazhohet universiteti krahasuar me numrin e stafit akademik dhe studentëve (pika 4.7; *Kapitulli II Standardi I.1; Kapitulli II Standardi I.4; Kapitulli II Standardi I.6*)
- mospasjen nga ana e departamenteve e një përqendrimi të qartë dhe gjithëpërfshirës kundrejt veprimtarisë kërkimore (pika 4.9; *Kapitulli II Standardi I.4*).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- ndjekjen e hapave nga universiteti për gjetjen e një mënyre për kualifikimin e të gjithë studentëve të regjistruar në programin doktorat (pika 4.2; *Kapitulli I Standardi II.2*)

- ndjekjen e një qasjeje strategjike për zhvillimin e kërkimit dhe miratimin e një plan veprimi (pika 4.7; **Kapitulli II Standardi I.1; Kapitulli II Standardi I.4; Kapitulli II Standardi I.6**)
- qartësimin dhe zbatimin nga ana e universitetit të prioritetëve të tij për veprimtarinë kërkimore (pika 4.9; **Kapitulli II Standardi I.4**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur pjesërisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 Universiteti ndjek një politikë korrekte për pranimin e studentëve, nëpërmjet kuadrit të tij të politikës së regjistrimit. Kjo mbikëqyret nga Zyra e Regjistrimit, Transferimit dhe Ekuivalentimit të Studimeve (ZRTES) në Zyrën e Karrierës, Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët (ZKKMS), e cila i raporton Kryesekretarit të universitetit. Veprimtaritë e tij mbulojnë, për shembull, përzgjedhjen dhe orientimin e studentëve, organizimin e mbledhjeve këshillimore me përgjegjësit departamenteve dhe dekanët, ditët e orientimit rreth karrierës për maturantët dhe javën e hapur për studentët e rinj. Ai organizon gjithashtu takime në terren, duke përfshirë shkollat e mesme, dhe fushatat në media për rekrutimin e studentëve të rinj. **[RVV fq.45-46; 1.1 Neni 21; 3.1; M2; M4; M5]** Faqja e internetit mbulon në mënyrë gjithëpërfshirëse kriteret e pranimin dhe procesin e aplikimit. **[Linqe të shumta të kontrolluara më 04/04/17, që janë funksionale]** Kriteret e pranimin, regjistrimi dhe procedurat përcaktohen gjithashtu në Rregulloren e secilit program studimi. **[1.2 Neni 43]** Universiteti është i hapur për rekrutimin e studentëve të huaj, por aktualisht ka vetëm një numër të vogël të studentëve të huaj. Ai është në pritje të aplikimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për zgjerimin e rekrutimit të studentëve të huaj, nëpërmjet futjes së gjashtë programeve të reja në fund të vitit 2017, që do të zhvillohen në gjuhën italiane. **[RVV fq.46; 5.1; M1]** Oraret e pritjes të studentëve afishohen në zyrat e stafit administrativ **[RVV fq.46]**, ndërsa në faqen zyrtare të internetit publikohen informacione të kontakteve të përgjegjësve të departamenteve dhe zyrat e shërbimeve studentore. **[Kontrolluar më 04/04/17]** Raporti aktual pedagog/student është 1:14 në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, 1:20 në Fakultetin e Shkencave Shoqërore dhe 1:14 në Fakultetin e Shkencave Mjekësore. **[RVV fq.46; 5.2] [Kapitulli I Standardi III.1]**

5.2 Universiteti komunikon me studentët dhe stafin në shumë mënyra, ndërsa të gjithë ata kanë adresa emaili. ZRTES dhe ZKKMS janë përcjellësit kryesorë të komunikimit të brendshëm dhe mbështetjes për studentët, **[RVV fq.46; M4]** të cilat përdorin emailin, telefonin, posterat, sekretarinë, mbledhjet e hapura të departamentit dhe Këshillin Studentor. **[RVV fq.47; M5]** Mjetet e jashtme të komunikimit me stafin dhe studentët përfshijnë faqen e tij të internetit. **[Faqja e internetit e AU 04/04/17; faqja e internetit e televizionit “UTV News”; RVV fq. 46]** Universiteti mban një dosje personale për të gjithë studentët e tij, e cila përfshin të dhënat e aplikimit, adresën e emailit, numrat e kontaktit dhe të dhëna për performancën e tyre. Këto dosje administrohen nga sekretaritë dhe arkivohen pas diplomimit të studentëve. **[RVV fq.46; 1.2 neni 40, neni 47; M4] [Kapitulli I Standardi III.2]**

5.3 Universiteti i orienton dhe këshillon si duhet studentët e tij. Studentët i treguan Grupit të Vlerësimit të Jashtëm se çdo pedagog i shpjegon të gjitha aspektet e secilit modul në fillim të çdo semestri, dhe se ata janë të kënaqur me baraspeshën ndërmjet njohurive teorive dhe atyre praktike në programet e tyre. **[M5; M8]** ZRTES është gjithashtu përgjegjëse për këshillimin dhe konsultimin e studentëve që nga kontakti i tyre fillestar me universitetin, duke iu ofruar informacion për programet e tyre, deri pas diplomimit. **[RVV fq.46]** Kjo përfshin këshillim dhe tutorim akademik, këshillim dhe mentorim metodologjik, si dhe leksione të hapura. Ai vë në dispozicion Manualin e Studentëve, **[RVV fq.48; 5.4]** që është një dokument i përshtatshëm, i cili përfshin të drejtat dhe detyrimet e studentëve, transferimin e studentëve, dhe procedurat disiplinore. Ato nuk përfshijnë procedurat e vlerësimit ose ankimimit. **[RVV fq.48; 5.4; 1.2 neni 44]** Universiteti iu ofron studenteve mundësinë të transferojnë programet e studimit të tyre, ndërsa ZKKMS i orienton studentët gjatë këtij procesi. **[5.4 fq.10-11; 2.32; M2]** Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë i informon studentët për akreditimin e universitetit, programet e studimit, dhe procedurat e njohjes dhe njehsimit të diplomave në Shqipëri dhe jashtë vendit. **[RVV fq.48] [Kapitulli I Standardi III.3]**

5.4 Universiteti mbështet studentët e kategorive të veçanta sociale, si komunitetet rome dhe egjiptiane, në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. **[RVV fq. 48]** Universiteti ofron gjashtë lloje bursash, kryesisht për studentët shqiptarë, por edhe për ata të huaj. **[RVV fq. 48-49; 1.2 Neni 50; 1.16 fq.21; 5.5]** Aksesit për personat me aftësi të kufizuara është i kufizuar në tre ndërtesat e tij dhe studentët u shprehën se ishin të pakënaqur për sa i përket rampave për këta studentë. **[Pyetësor i Studentëve 15; M10]** Studentët angazhohen në shkallë të gjerë në sporte dhe mbështeten **[RVV fq.49]** nëpërmjet një marrëveshjeje bashkëpunimi me Qendrën Fari, **[A.5.6]**, por sipas anketimit të studentëve rezultoi se ata nuk ishin të kënaqur me ambientet e brendshme dhe të jashtme sportive **[Pyetësor i Studentëve 15]**, ndërsa studentët e ciklit të tretë theksuan mungesën e veprimtarive sociale. **[M6]** Universiteti parashikon lehtësira të posaçme për studentët që janë në marrëdhënie pune, duke i zhvilluar disa prej orëve mësimore gjatë pasdites ose në fundjavë. **[RVV fq.49; M6] [Kapitulli I Standardi III.4]**

5.5 Universiteti ofron literaturën bazë të përshtatshme për studentët. **[1.16, fq.22-23]** Tre bibliotekat e tij të vogla, që janë edhe salla studimi, kanë rreth 4,109 libra në format të shtypur dhe studentët kanë akses në materiale të tjera në tre bibliotekat online, duke përfshirë “QUESTIA” dhe “ELSEVERE”, në botimet e shtëpisë botuese “University Press” që ndihmon me përkthimin, në bibliotekat ‘e vogla’ të departamenti dhe në materiale të ofruara nga stafi. **[M5; M10]** Universiteti e pasuron fondin e tij me fonde të veçanta të dedikuara për blerjen e librave të rinj, **[RVV fq.50; 5.7a,b,c; M3]** dhe ka një buxhet vjetor për literaturë të specializuar, për të cilat bën oferta departamenti. **[RVV fq.50; M15]** Orët e hapjes së bibliotekës afishohen në çdo ndërtesë. **[M10; RVV fq.51]** Studentët u shprehën shumë të kënaqur me materialet e tyre të mësimnxënies, veçanërisht me bibliotekat online dhe librat më të fundit të përkthyer në fushën mjekësore dhe edukative. **[M5] [Kapitulli I Standardi III.5]**

5.6 Universiteti iu ofron studentëve të ciklit të parë mbështetjen e duhur, nëpërmjet programeve të tyre të studimit. Nuk ka një sistem individual tutorimi, por studentët kanë udhëheqës individualë, kur punojnë për një projekt ose për tezën e tyre të diplomës, ndërsa ZRTES siguron këshilltarë në mënyrë private dhe konfidenciale. **[RVV fq.51; 5.8 nenet 30-33; M5]** Udhëzimi i studentëve se si të gjejnë literaturë e duhur realizohet në mënyrë të shumta, nëpërmjet syllabusit të lëndës, stafit akademik, pedagogëve, personelit të bibliotekës, dhe sekretarive. **[RVV fq.51]** Universiteti nuk ofron kurse të veçanta, por ofron orë konsultimi në departamente me pedagogët e kursit për studentët që kanë vështirësi. **[RVV fq.51]** ZRTES ofron leksione të hapura për përgatitjen e tezës së diplomës dhe një “Manual” për punimin e saj. **[RVV fq.52]** ZRTES ka edhe një “Seksion të këshillimit psikologjik”, që i ndihmon studentët të përshtaten me programin e tyre të studimit, menaxhimin e stresit të shkaktuar nga provimet dhe problemet personale. Informacioni për këshillimin psikologjik shpallet në buletin e informimit të studentëve. **[RVV fq.48; M5] [Kapitulli I Standardi III.6]**

5.7 Universiteti i nxit studentët të marrin pjesë në jetën universitare. Ai e mbështet financiarisht Këshillin Studentor të organizuar në formë zyrtare, ku marrin pjesë një numër i madh studentësh, i cili udhëhiqet nga rregullorja e tij. **[RVV fq.52; 1.1 neni 38; 1.2 neni 52]** Rregullorja përshkruan qartësisht objektivat, përbërjen, çështjet organizative dhe operacionale, **[5.9]** por nuk përshkruan se si bashkëpunojnë këshillat me organet drejtuese të universitetit dhe të fakulteteve për përmirësimin e mësimdhënies dhe kërkimit. **[5.9 neni 4, 4]** Megjithatë, studentët e vlerësojnë shumë Këshillin dhe nuk ndeshen me probleme në jetën e tyre universitare. Këshilli ka nga një përfaqësues për çdo klasë, dhe në total ka 70 studentë. Ata zgjedhin një kryetar, i cili i përfaqëson ata në Senatin Akademik. Një tjetër anëtar i Këshillit Studentor, gjithashtu i zgjedhur, merr pjesë në Bordin e Administrimit. Një përfaqësues i Këshillit Studentor merr pjesë në të gjitha bordet e fakultetit. **[RVV fq.52; 1.1 nenet 8.2, 19.2]** Studentët nuk kanë probleme lidhur me dëgjimin e zërit të tyre dhe arrijnë e rezultateve të shpejta. Problemet menaxhohen zakonisht në mënyrë individuale në nivel

departamenti, por mund të zgjidhen edhe nëpërmjet Këshillit Studentor. Dy shembujt e dhënë lidhen me problemet për orarin dhe nevojën për më shumë laboratorë farmacie; të dyja këto probleme u trajtuan në një kohët të shkurtër. **[M5]** Zëri i studentëve dëgjohej nëpërmjet pyetësorëve, që plotësohen në fund të çdo semestri; studentët përmendën një shembull të hartimit të kërkesave për më shumë pajisje në klasë, të cilat u shqyrtuan vitin pasardhës. **[M5]** Nxitja dhe vëmendja e kushtuar ndaj zërit të studentëve në mënyrë që ata të luajnë një rol efikas në përmirësimin e përvojave të tyre arsimore përbën **praktikë e mirë**. Fakultetet organizojnë gjithashtu konferenca studentore dhe botojnë punimet e tyre. **[5.10; M3] [Kapitulli I Standardi III.7]**

5.8 Universiteti i kushton më pak vëmendje jetës kulturore dhe sportive të studentëve të saj. ZRTES organizon veprimtari ekstrakurrikulare shkencore, profesionale, sociale dhe kulturore. **[RVV fq.53; 5.3c]** Universiteti ka nëntë klube studentore, tre në secilin prej tre fakulteteve, dhe një rregullore për organizimin e tyre. **[RVV fq.53; 5.11]** Secili klub ka Bordin e Administrimit që përbëhet nga dekani i fakultetit, një anëtar i stafit akademik me kohë të plotë dhe tre përfaqësues të studentëve. **[5.11 neni 3, fq.2]** Mbetet e paqartë shkalla e funksionimit të klubeve, për shkak se kur u pyetën, studentët nuk i përmendën ato në shembujt e tyre për veprimtaritë sociale, që përfshinin veprimtari bamirësie, pastrimin e qytetit, punë për kujdesin shëndetësor dhe kujdesin për të moshuarit, futbollin, volejbollin dhe higjienë orale në shkolla, dhe për shkak të mungesës së aksesit në dokumente të tjera të mundshme. **[M5]** Universiteti ofron akomodim pranë ambienteve të tij. Asnjë prej studentëve që takoi Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk jetonte në to, por ata raportuan se kolegët e tyre që jetonin në to ishin të kënaqur. **[1.16, fq.23-24; M5]** Universiteti bashkëpunon me strukturat shëndetësore që ndjekin politika të ndihmë mjekësore parandaluese dhe kurative për studentët; për shembull, organizohen veprimtari periodike me Kryqin e Kuq. **[Kapitulli I Standardi III.8]**

5.9 Universiteti i ndihmon studentët për të gjetur vend pune. ZRTES luan sërish një rol qendror brenda universitetit, për të ndihmuar rrjetin e studentëve dhe integrimin e tyre në tregun e punës. **[RVV fq.54; 1.16 p.11; M3]** Shërbimi i saj është i hapur, por studentët mund të lënë takime. **[M4]** Ai mbledh të dhëna për normat e punësimit të studentëve sipas fushës së tyre të studimit dhe vitit të diplomimit, dhe shërben si urë lidhëse për punësimin nëpërmjet partnerit alumni. **[3.12; M11; M12/13; M15]** Studentët u shprehën të kënaqur me ndihmën që iu ofrohet nga ZRTES dhe veçanërisht nga alumni dhe rrjetet e tyre. **[M5; M12/13]** Universiteti bashkëpunon me punëdhënës dhe ka nënshkruar 46 marrëveshje për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve në fusha si: stomatologjia, infermiera, arkitektura dhe psikologjia, ndërsa zhvillimet e ardhshme përfshijnë praktikën e inxhinierisë elektronike në një kompani telefonike (shihni pikat 1.10 dhe 1.11). **[1.25; M6]** Ai bën analizë të tregut të punës, që përfshin vendet e punësimit sipas fushës ose lëndës, reagimin e punëdhënësve dhe rekomandime për përdorimin e analizës, me qëllim përmirësimin e programeve për punësimin më të mirë të studentëve në të ardhmen. (shihni pikën 1.8). **[1.20 fq.10-15, fq.20; M3]** Universiteti merr pjesë në një Panair vjetor të Karrierës, ndërsa gjatë vizitës u organizua panairi i karrierës në ambientet e tij. **[RVV fq.54; 3.11 Video e AU për Panairin e Punës (që nuk është parë); 5.3; M1]** Universiteti punëson disa prej studentëve brenda institucionit, dhe disa prej anëtarëve të stafit të tij administrativ dhe akademik studiojnë në nivelin PhD dhe Master. **[RVV fq.54; 2.3; M6; M12/13]** Ai i shpall vendet e tij të lira për studentët e diplomuar dhe studentët e vitit të fundit, dhe i publikon ato edhe në faqen e tij të internetit. **[RVV fq.54]** ZRTES ofron këshilla për karrierën dhe për përshtatjen me tregun e punës dhe iu jep udhëzime studentëve gjatë një leksioni të hapur në vitin e tretë. **[RVV fq.46-47; 5.3] [Kapitulli I Standardi III.9]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- nxitjen dhe vëmendjen e kushtuar ndaj zërit të studentëve, në mënyrë që ata të luajnë një rol efikas në përmirësimin e përvojave të tyre mësimore (pika 5.7; ***Kapitulli I Standardi III.7***).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur.

Lista e dokumenteve

Dokumente, fusha e vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- [1.1] Statuti i “Albanian University”.pdf
- [1.2] Rregullorja Institucionale e AU.pdf
- [1.3] Vendimi i Senatit Akademik për riorganizimin e Statutit.pdf
- [1.4] Statuti i riorganizuar sipas ligjit 80/15.pdf
- [1.5] Urdhri i MAS për miratimin e Statutit të ri.pdf
- [1.6] Vendimi i Senatit.pdf
- [1.7] Rregullorja e AU e riorganizuar sipas ligjit nr. 80/15.pdf
- [1.8a] Rregullorja e Senatit Akademik.pdf
- [1.8b] Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Rektoratit.pdf
- [1.9] Kodi i Etikës.pdf
- [1.10] Rregullorja e Bordit të Administrimit.pdf
- [1.11] Manuali i Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf
- [1.12] Vendimi i Senatit për ngritjen e Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.pdf
- [1.13] Vendimi i Senatit, datë 08.09.2016.pdf
- [1.14] Vendimi i Bordit të Administrimit.pdf
- [1.15] Lista e aplikimeve për pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare.pdf
- [1.16a] Strategjia e Zhvillimit Institucional 2013-2017.pdf
- [1.17] Raporti Vjetor i Vlerësimit, ZSBC.pdf
- [1.18] Vendimi i Senatit, datë 28.09.2016.pdf
- [1.19] Statistikat e stafit akademik për vitin 2016-2017.pdf
- [1.20] Model i Studimit të Tregut të Punës.pdf
- [1.21] Strategjia e Partneritetit dhe Komunikimit.pdf
- [1.22] Lista e pedagogëve të huaj të ftuar në AU.pdf
- [1.23] Lista e institucioneve të huaja të arsimit të lartë me të cilat AU ka marrëveshje bashkëpunimi.pdf
- [1.24] poster Erasmus + dhe se si të bëheni pjesë e tij.pdf
- [1.25] Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit për praktikantët mësimorë.pdf
- [1.26] Lista e institucioneve me të cilat AU ka marrëveshje bashkëpunimi.pdf
- [1.27] Lista e konferencave shkencore të organizuara në bashkëpunim me universitete të huaja.pdf
- [1.28] Evidencë e studentëve të huaj në AU.pdf
- [1.29] Evidencë mbi pedagogët e huaj të angazhuar në mësimdhënie.pdf

Dokumente, fusha e vlerësimit 2: Burimet

- [2.1] Organogramë e AU.pdf
- [2.2] Kontrata e “UTV News” dhe njoftimet për vende vakante.pdf
- [2.3] Lista emërore e të diplomuarve në AU dhe të punësuar në AU.pdf
- [2.4a] Modele të kontratave të punësimit të stafit akademik me kohë të plotë.pdf
- [2.4b] Modele të kontratave të punësimit të stafit akademik me kohë të pjesshme.pdf
- [2.4c] Modele të kontratave të Shërbimit.pdf
- [2.4d] Modele të kontratave punësimit të personelit administrativ.pdf
- [2.4e] Model i Kontratës Shtojcë.pdf
- [2.5] Lista e stafit akademik të arsimuar jashtë vendit.pdf
- [2.6a] Axhenda e trajnimit të stafit akademik.pdf
- [2.6c] Përmbledhje e trajnimit të stafit akademik.pdf
- [2.10a] Lista e konferencave të organizuara nga AU.pdf
- [2.11] Shembull evidence financiare – mbështetje stafi.pdf
- [2.12] Revista “OPTIME” nr. 1, 2016.pdf
- [2.13] Lista e botimeve nga shtëpia botuese “AU Press”.pdf
- [2.14a] Marrëveshje institucionale me Universitetin e Palermos.pdf
- [2.14b] Marrëveshje institucionale me Universitetin e Pisas.pdf

- [2.15] Formular vlerësimi për performancën e stafit nga përgjegjësi i departamentit.pdf
- [2.16] Model pyetësi i studentëve.pdf
- [2.17] Bordi Drejtues i revistës “OPTIME”.pdf
- [2.18a] Marrëveshje bashkëpunimi me Kryqin e Kuq Shqiptar.pdf
- [2.18b] Dokumente shtesë nga veprimtari sociale.pdf
- [2.18c] Video – dëshmi shqiptare.pdf
- [2.19] Dokumentacion që përmban dosjet e punëmarrësit.pdf
- [2.21] Vendimi i Bordit të Administrimit për miratimin e buxhetit vjetor.pdf
- [2.22] Rregullorja e mirëmbajtjes së faqes së internetit.pdf
- [2.24b] Kapacitetet infrastrukturore 2016-2017.pdf
- [2.24c] Raport i përmbledhur për institucionin, kapaciteti infrastrukturor.pdf
- [2.25] Rregullore e Zyrës së Protokoll-Arkivës.pdf
- [2.26] Lista e figurave akademike të nderuara në AU.pdf
- [2.28a] Lista e laboratorëve të FSHAE.pdf
- [2.28b] Lista e laboratorëve të FSHM.pdf
- [2.28c] Lista e laboratorëve të Fakultetit të Shkencave Shoqërore.pdf
- [2.29] Marrëveshje bashkëpunimi me Kolegjin Shqiptar.pdf
- [2.32] Rregullore për Transferimin e Studentëve.pdf

Dokumente, fusha e vlerësimit 3: Kurrikula

- [3.1] Poster që reklamon Ditët e Hapura në AU
- [3.2] Rregullore e programit të studimit Bachelor “Financë-Bankë”.pdf
- [3.3] Manual – Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave.pdf
- [3.5a] Manifesti Akademik.pdf
- [3.5-b] Broshurë informimi për programet e studimit 2016-2017.pdf
- [3.6] Rregullore e programit të studimit për Shkencat Politiko-Administrative.pdf
- [3.8] Model syllabusi.pdf
- [3.9] Propozim për hapjen e programit Master Profesional në Fizioterapi.pdf
- [3.10a] Rregullore për programin e studimit Master i Shkencave në Farmaci.pdf
- [3.10b] Model dokumentacioni mbrojtjeje diplome.pdf
- [3.10c1] Miratim i disertacionit.pdf
- [3.10c2] Deklaratë e studentit.pdf
- [3.10c3] Formular mentorimi.pdf
- [3.10c4] Model i vlerësimit të disertacionit.pdf
- [3.12] Dokumente për punësimin e studentëve sipas fushës së tyre të studimit.pdf
- [3.14a] Suplement i diplomës së studentit.pdf
- [3.14b] Transkript i regjistrimeve të studentëve.pdf
- [3.15a] Lista e transferimit të studentëve në Fakultetin e Shkencave Mjekësore.pdf
- [3.15b] Lista e transferimit të studentëve në Fakultetin e Shkencave Shoqërore.pdf
- [3.15c] Lista e transferimit të studentëve në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.pdf

Dokumente, fusha e vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- [4.1a] Procedura për rishikimin e planeve mësimore.pdf
- [4.1b] Procedura për ndryshimet e planeve mësimore – Inxhinieria mekatronike.pdf
- [4.1c] Procedura për ndryshimet e planeve mësimore - Farmaci.pdf
- [4.2a] Detyrimi i studentëve për përfundimin e stazhit.pdf
- [4.2b] Veprimtaritë e detyruara të stazhit.pdf
- [4.2c] Vlerësimi i përvojës së stazhit.pdf
- [4.3] Model i Raportit Vjetor nga Dekani.pdf
- [4.4] Model i Raportit Vjetor nga përgjegjësi i departamentit.pdf
- [4.5] Model i raportit të vetëvlerësimit për procesin e mësimnxënies.pdf
- [4.6] Model formulari i deklaramit të veprimtarive kërkimore dhe shkencore për stafin akademik.pdf
- [4.7] Vendim për zhvillimin e studimit të tregut të punës.pdf

[4.8]Lista e stafit akademik që ndjek programin e ciklit të tretë në AU.pdf
[4.9]Përmbledhje e botimeve 2011-2016.pdf

Dokumente, fusha e vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

[5.2] Evidenca mbi raportin student/pedagog.pdf
[5.3a] Rregullore e Zyrës së Zhvillimit të Karrierës.pdf
[5.3b] Udhëzuesi për Zhvillimin e Karrierës.pdf
[5.3c] Axbenda e veprimtarive vjetore.pdf
[5.4] Manuali i Studentit.pdf
[5.5] Evidenca e bursave për vitin akademik 2016-2017.pdf
[5.7a] Kërkesë e departamentit për blerjen e librave.pdf
[5.7b] Kërkesë e dekanit për miratim nga Bordi i Administrimit.pdf
[5.7c] Vendim i Bordit të Administrimit.pdf
[5.8] Rregullore për Masterin e Shkencave në Arkitekturë.pdf
[5.9] Rregullore për Këshillin Studentor.pdf
[5.11] Rregullore e klubeve studentore.pdf

Dokumente të tjera

AE1 - a Rregullore, Fakulteti i Shkencave Mjekësore.pdf
AE1 - b Rregullore, Fakulteti i Shkencave Shoqërore.pdf
AE1 - c Rregullore, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.pdf
AE2 - a1 Rregullore për Bachelor në Infermieri.pdf
AE2 - a2 Rregullore për Master Profesional në Infermierinë Kirurgjikale.pdf
AE2 - a3 Rregullore për Specializim në Ortodonti.pdf
AE2 - b1 Rregullore për Master Profesional në Edukim, profili Didaktikë.pdf
AE2 - b2 Rregullore për Master i Shkencave në Shkencat Juridike.pdf
AE2 - c1 Rregullore për Master Profesional në Menaxhimin Bankar dhe Financiar.pdf
AE2 - c2 Rregullore për Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike.pdf
AE3 - a1 Bachelor në Infermieri Syllabusi I Viti.pdf
AE3 - a1 Bachelor në Infermieri Syllabusi II Viti.pdf
AE3 - a1 Bachelor në Infermieri Syllabusi III Viti.pdf
AE3 - a2 Master Profesional në Infermieri Kirurgjikale.pdf
AE3 - a3 Master i Shkencave në Farmaci Syllabusi I Viti.pdf
AE3 - a3 Master i Shkencave në Farmaci Syllabusi II Viti.pdf
AE3 - a3 Master i Shkencave në Farmaci Syllabusi III Viti.pdf
AE3 - a3 Master i Shkencave në Farmaci Syllabusi IV Viti.pdf
AE3 - a3 Master i Shkencave në Farmaci Syllabusi V Viti.pdf
AE3 - a4 PhD në Shkenca Farmaceutike.pdf
AE3 - a5 SPA në Ortodonti Syllabusi I Viti.pdf
AE3 - a5 SPA në Ortodonti Syllabusi II Viti.pdf
AE3 - a5 SPA në Ortodonti Syllabusi III Viti.pdf
AE3 - b1 Bsc. në Shkenca Politiko-Administrative Syllabusi.pdf
AE3 - b2 Mp. në Edukim, me profil Didaktikë syllabusi.pdf
AE3 - b3 Master i Shkencave në Shkencat Juridike.pdf
AE3 - b4 PhD në Psikologji Klinike Syllabusi.pdf
AE3 - c1 Bachelor në Financë-Bankë Syllabusi I Viti.pdf
AE3 - c1 Bachelor in në Financë-Bankë Syllabusi II Viti.pdf
AE3 - c1 Bachelor në Financë-Bankë Syllabusi III Viti.pdf
AE3 - c2 Master Profesional në Menaxhimin Bankar dhe Financiar.pdf
AE3 - c3 Master i Shkencave në Arkitekturë Syllabusi I Viti.pdf
AE3 - c3 Master i Shkencave në Arkitekturë Syllabusi II Viti.pdf
AE3 - c3 Master i Shkencave në Arkitekturë Syllabusi III Viti.pdf
AE3 - c3 Master i Shkencave në Arkitekturë Syllabusi IV Viti.pdf
AE3 - c3 Master i Shkencave në Arkitekturë Syllabusi V Viti.pdf
AE3 - c4 Master i Shkencave në Inxhinierinë Mekatronike Syllabusi I Viti.pdf

AE3 - c4 Master i Shkencave në Inxhinierinë Mekatronike Syllabusi II Viti.pdf
 AE3 - c5 PhD në Arkitekturë Syllabusi.pdf
 AE4 - a Kontratë studimi Bsc në fizioterapi.pdf
 AE4 - b Kontratë studimi Master Profesional në Infermieri Kirurgjikale.pdf
 AE4 - c Kontratë studimi Msc. në Stomatologji.pdf
 AE4 - d Kontratë studimi programi i studimit PhD.pdf
 AE5 - a Formular aplikimi për Bachelor.pdf
 AE5 - b Formular aplikimi për Master Profesional.pdf
 AE5 - c Formular aplikimi për Master të Shkencave.pdf
 AE5 - d Formular aplikimi për programe Phd.pdf
 AE6 - a Raport vjetor, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.pdf
 AE6 - b Raport vjetor, Fakulteti i Shkencave Shoqërore 2015 - 2016.pdf
 AE7 – Rregullore e Burimeve Njerëzore.pdf
 AE8 – Sisteme informacioni që mbështesin organizimin institucional.pdf
 AE9 – Sisteme të Menaxhimit të Informacionit në Arsim.pdf
 A.2.6 - b Njoftim për trajnim të stafit akademik.pdf
 A.2.6 - d Temat e trajnimit 2015-2016.pdf
 A.2.7 Shembull evidence të trajnimit të stafit administrativ.pdf
 A.2.10 - b video.pdf
 A.2.20 - Plani buxhetor afatmesëm 3 vjeçar 2017-2019.pdf
 A.2.23 - a Kontratë Qiraje Bulevardi Zogu i I (Ish estrada).pdf
 A.2.23 - b Kontratë Qiraje Bulevardi Zogu i I (Ish gjykata I).pdf
 A.2.23 - c Kontratë Qiraje Rruga e Durrësit (Ish gjykata II).pdf
 A.2.23 - d Kontratë Qiraje Rruga e Kavajës (Raiffeisen).pdf
 A.2.23 - e Kontratë Qiraje Rruga e Kavajës (Ish hotel Adriatik).pdf
 A.2.23 - f Kontratë Qiraje (Internacionali I).pdf
 A.2.23 - g Kontratë Qiraje (Internacionali II).pdf
 A.2.23 - h Kontratë Qiraje Rruga e Elbasanit (Ish universiteti amerikan).pdf
 A.2.24 - a-1 Godina në Bulevardin Zogu I - Ish Estrada.pdf
 A.2.24 - a-2 Godina në Rrugën e Durrësit - Ish Gjukata (FSHM).pdf
 A.2.24 - a-3 Godina në Rrugën K. Karafili - Internacionali (FSHM).pdf
 A.2.24 - a-4 Raiffeisen-planimetria.pdf
 A.2.24 - a-5 Godina në Rrugën e Kavajës.pdf
 A.2.24 - a-6 Godina në Rrugën e Elbasanit - Ish Univ.Amerikan.pdf
 A.2.27 - Lejet higjieno-sanitare të 6 godinave të AU.pdf
 A.2.30 - Akte teknike mbrojtjeje nga zjarri dhe shpëtimi.pdf
 A.2.31 - Shkresë mbi kuotat e pranimit drejtuar MAS 11.01.2017.pdf
 A.3.1 - a Poster i veprimtarisë në Ditët e Orientimit të Karrierës së Maturantit.pdf
 A.3.4 - Udhëzimi nr. 20 për shpërndarjen e ngarkesës mësimore.pdf
 A.3.7 - Printscreen Web, Kriteret e pranimit të studentëve.pdf
 A.3.13 - Leja e UMT për pedagogët e jashtëm në AU.pdf
 A.5.1 - Kërkesë drejtuar MAS për hapjen e programeve në gjuhë të huaj.pdf
 Marrëveshje bashkëpunimi me qendrën sportive Fari.pdf
 A.5.10 - a Model libër abstraktesh FSHAE.pdf
 A.5.10 - b Model libër abstraktesh FSHAE.pdf
 A.5.10 - c Model libër abstraktesh FSHSH.pdf
 A.5.10 - d Model libër abstraktesh FSHM.pdf
 Lidhjet e Evidencave (1.24-b; 2.8; 2.8; 2.19; 2.26-b; 3.1-b; 3.11; 3.16).pdf
 GID Albanian University- versioni përfundimtar.pdf

B. Lista e dokumenteve shtesë (faza e vlerësimit e bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit)

B.1 AU fusha 3 eksperti 1 DT.docx
 B.2 AU fusha 2 eksperti 2 - DT.docx

- B.3 AU fusha 4 eksperti 2 - DT.docx
- B.4 Strukturat e Komisionit.pdf
- B.5 Dokumenti 2.8.pdf – Sistemet e informacionit që mbështesin organizimin institucional.pdf
- B.6 Dokumenti 2.9.pdf – Sistemet e Menaxhimit të Informacionit në Arsim.pdf
- B.7 Dokumenti 3.4.pdf - Udhëzimi nr. 20 për shpërndarjen e ngarkesës mësimore.pdf
- B.8 Dokumenti _i_Syllabusit_ që iu jepet studentëve.PDF
- B.9 Vlerësimi Vjetor i Programit.pdf

C. Lista e dokumenteve shtesë nga vizitat e vlerësimit të jashtëm

- C.1 Axhenda në gjuhën angleze.pdf
 - C.2 /M-2L'Universita degli Studi di Napoli, Federico II.pdf
 - C.3/M-2Universiteti Bujqësor i Tiranës.pdf
 - C.4/M-2Marrëveshje ndërinstitucionale me Kolegjin Powislanski.pdf
 - C.5/M-2Lloji i bashkëpunimit bazuar në Marrëveshje.pdf
 - C.6 Stafit i ri akademik i arsimuar jashtë vendit.pdf
 - C.7 Statistika të stafit 2012-2017.AL.pdf
 - C.8 Model Kontrate Pedagogu 1.AL.pdf
 - C.9 Model Kontrate Pedagogu 2.AL.pdf
 - C.10 Organograma.pdf
 - C.11 Përshkrimi i Organogramës.pdf
 - C.12 Dërgim i raportit vjetor nga drejtuesi i departamentit.AL.pdf
 - C.13 Dërgim i raportit vjetor nga Dekani.AL.pdf
 - C.14 Dërgimi i raportit vjetor të ZSBC te Rektori.AL.pdf
 - C.15 Procesverbal Rektorati ku diskutohet raporti vjetor.AL.pdf
 - C.16 Vendim senati - miratimi i raportit vjetor.AL.pdf
 - C.17 PROCEDURA KONKRETE E NDËRLIDHJES SË STRUKTURAVE NË AU.AL.pdf
 - C.18 Dërgimi i Raportit Vjetor nga përgjegjësi i departamentit te Dekani.pdf
 - C.19 Dërgimi i Raportit Vjetor nga Dekani te ZSBC.pdf
 - C.20 Dërgimi i Raportit të ZSBC te Rektori.pdf
 - C.21 Procesverbal i takimit të Rektoratit ku është diskutuar Raporti Vjetor.AL.pdf
 - C.22 Vendimi i Senatit, datë 28.09.2016, për miratimin e raportit vjetor.pdf
 - C.23 Procesi i raportimit nga departamenti te Senati Akademik.pdf
 - C.24 Kryetari i bordit të administrimit.pdf
 - C.25 Përzgjedhja e Kryetarit të Bordit të Administrimit.pdf
 - C.26 Veprimtaria e Bordit të Administrimit.pdf
 - C.27 Përshkrimi i Strukturës Organizative të AU.pdf
 - C.28 Struktura Organizative Institucionale.pdf
 - C.29 Dorëzimi i raportit vjetor.pdf
 - C.30 Procesverbali i Takimit të Rektoratit.pdf
 - C.31 Linja e raportimit - shembull.pdf
 - C.32 Fotografi e laboratorit të fizioterapisë.pdf
- 196 Mbledhja e të dhënave nga Institucionet e Arsimit të Lartë sipas procesit të Vlerësimit Institucionale

Procesverbalet e Mbledhjeve

- M1, Mbledhja me Rektorin
- M2, Mbledhja me Grupin e Vetëvlerësimit
- M3, Mbledhja me Senatit Akademik (përveç Rektorit)
- M4, Mbledhja me Rektoratin (përveç Rektorit)
- M5, Mbledhja me studentët
- M6, Mbledhja me studentët
- M8, Mbledhja me partnerë të jashtëm dhe alumni
- M10, Turi i në ambientet e universitetit
- M11, Mbledhja me përgjegjësit e departamenteve dhe sekretaritë administrative

M12/13, Mbledhja me pedagogët, stafin e lartë të kërkimit dhe stafin e mësimdhënies që nuk janë pjesë e profesoratit
M14, Mbledhja me stafin e ri që janë aktivë në kërkim
M15, Mbledhja me Bordin e Administrimit dhe përgjegjësit e administrimit